



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 20 DHJETOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 20 DECEMBRA. 2012. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR  
2012**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbaremore,
6. Shqyrtimi i Raportit të punës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011.

## **Dnevni red**

1. Vreme za izjašnjavanje izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o sudovima,,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izvršnom postupku,
6. Razmatranje Izveštaja o radu Sudskog veća Kosova za 2011. godinu.

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.**

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,  
Të nderuara deputete,  
I nderuar Kabinet qeveritar,  
Ministra,

Hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendi të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Njëherësh dua të ju njoftoj që në pajtim me nenin 37 të Rregullores, me këtë seancë përmbyllet sesioni vjeshtor i punimeve të Kuvendit, ndërsa sesioni pranveror fillon të hënën e tretë të muajit janar 2013. Ju uroj festat e fundvitit të gjithëve! Me këtë rast edhe gjithë qytetarëve të Kosovës, në emrin tuaj!

Lidhur me rendin e ditës, në pajtim me nenin 22, pika 2 e Rregullores, fjalën e ka kërkuar Grupi i Grave Deputete, përkatësisht zonja Brovina.

FLORA BROVINA: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Grupi i Grave Deputete dhe përkrahësit tjerë të nënshkruar e kanë parashtruar një rezolutë për fuqizimin e gruas, e cila quhet “Rezoluta - Parimet e Prishtinës” dhe ka për qëllim të procedohet në Kombet e Bashkuara. Kemi kërkuar që kjo të rrjedhë, të procedohet sot dhe të votohet nga grupet parlamentare, ndërkaq rrjedh nga konferenca që u mbajt para disa muajsh në Prishtinë, Konferenca Ndërkombëtare e Grave. Kjo duhet të votohet me urgjencë në këtë fundvit, në mënyrë që të arrijë me kohë atje ku e kemi adresuar. Ju kisha lutur që ta përkrahim, pasi kemi marrë edhe pëlqimin e grupeve parlamentare që të hyjë në procedurë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Këtë mocioni e lëmë për më vonë, sepse nuk kemi kuorum, po mund ta trajtojmë si grupe parlamentare...

*(Reagim dikush nga salla: Kur të vijë te rendi i ditës.)*

...po, vetëm sa për njoftim, besoj që deri atëherë do të plotësohet edhe numri i nevojshëm.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Në emër të Grupit Parlamentar, fjalën e ka zoti Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Një vit me plot të arritura në Kosovë mund të vlerësohet viti që po e lëmë pas. Si shteti më i ri në Evropë, Republika e Kosovës kaloi nëpër shumë sfida edhe në vitin e saj të katërt të pavarësisë dhe shënoi edhe hapa përpara. Sfidues ishte po këtë vit dialogu Kosovë-Serbi, i dizajnuar dhe i mbështetur nga miqtë tanë nga bashkësia ndërkombëtare. Ritmi i shtuar i njohjeve të shtetit të Kosovës në botë dhe përmbyllja e periudhës mbikëqyrëse të pavarësisë ishin dy zhvillime të tjera, që në fakt i dhanë impakt më të madh punës së mirë të institucioneve të Kosovës brenda dhe jashtë vendit.

Qeveria e Republikës së Kosovës u dëshmuar jashtëzakonisht azhure, duke i kryer obligimet e brendshme dhe duke dëshmuar se është koha që tash të kalojnë më shumë kompetenca te vendorët dhe se duhet të përfundojë mbikëqyrja e pavarësisë, objektiv të cilin edhe e arriti. Në anën tjetër, një hov i shtuar dhe me plot dinamikë në aktivitetin diplomatik, bëri që Qeveria e Thaçit t'i sjellë shumë njohje tjera ndërkombëtare shtetit të Kosovës nga shumë vende, duke bërë kështu hapa të sigurt dhe të mëdhenj drejt lehtësimit të pozicionit ndërkombëtar të vendit tonë. Të gjitha këto, erdhën si sukses të politikës sonë, të brendshme dhe të jashtme, dhe si fitore mbi trysninë dhe destruktivitetin e vazhdueshëm ndërkombëtar që Qeveria e Serbisë e bënte ndaj Kosovës.

Tre krerët më të lartë të vendit tonë, në të njëjtën kohë ishin në ofensivë pune jashtë vendit, me angazhimin dhe prezantimin e tyre në tryezat rajonale e ndërkombëtare. Presidentja, kryeparlamentari dhe kryeministri kudo shënuan sukseset të mëtutjeshme për vendin dhe evidentuan të arriturat e reja në kalendarin diplomatik të Kosovës. Sukseset më të mëdha në këtë drejtim ishin takimet e nivelit të lartë në dy pikat tona orientuese, në Uashington e Bruksel, dhe mirëkuptimi, garancitë dhe mbështetja që krerët e shtetit tonë siguruan për Kosovën në këto qendra dhe të tjera të rëndësishme të botës. Në fushën e brendshme, një e arritur tjetër e madhe ishte statusi i avancuar dhe mandati i ri i Forcës së Sigurisë së Kosovës. Një impakt tjetër ky drejt fuqizimit të jetësimit të shtetit tonë.

Ato që i dhanë shije dhe e bënë realitet bashkimin kombëtar, në një formë, sivjet ishin manifestimet e shkëlqyeshme në 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë dhe përrurimi në po këtë jubile i autostradës së re, Rrugës së Kombit, që theu barrikatadat dhe vështirësitë e deritashme të lidhjes së komunikimit më të lehtë ndërmjet shqiptarëve. Rruga e Kombit u bë projekti më gjigant i rajonit, që do të ketë ndikim direkt edhe në jetën, përditshmërinë, qarkullimin dhe zhvillimin brenda shqiptarëve.

Duke cekur sukseset tjera të Qeverisë sonë, në rrafshin e jetësimit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës, i evidentueshëm dhe i prekshëm është edhe pranimi i pjesëmarrjes së Kosovës në federatat dhe garat ndërkombëtare sportive dhe pjesëmarrja e suksesshme në disa prej tyre. Pastaj, pranimi i Kosovës në Bankën për Zhvillim dhe Rindërtim, vendosja dhe njohja ndërkombëtare e kufirit të Kosovës me Serbinë - IBM, marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit me shtetet e ndryshme dhe shumë të tjera.

Përfundimi me sukses i procesit maratonik gjyqësor në Tribunalin e Hagës dhe konfirmimi i dytë i pafajësisë për ish-kryeministrin Ramush Haradinaj dhe bashkëluftëtarët e tij ishte një moment pikant dhe shumë i veçantë që ndodhi në këtë vit.

Procesi e dëshmoi edhe një herë pastërtinë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të drejtën që ishte dhe vazhdon të jetë në anën e popullit të Kosovës.

Njëkohësisht, i demantoj të gjitha shpifjet që u adresuan në këtë vit për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe vendin tonë. Po ashtu, në vazhdimësinë e këtyre proceseve, ne besojmë se edhe procesi kundër deputetit Fatmir Limaj dhe të tjerëve do ta dëshmojë po të njëjtën pastërti të luftës sonë të drejtë.

Miratimi i Ligjit për veteranët e luftës të UÇK-së sivjet është një satisfaksion tjetër, bashkë me nisjen e identifikimit dhe regjistrimit real të secilit prej tyre. Përmbyllja e suksesshme e regjimit të regjistrimit të popullsisë në Kosovë, është po ashtu njëri prej segmenteve që dëshmoi organizimin e mirë të institucioneve të Kosovës, në formësimin e shtetit tonë, duke organizuar edhe procese të këtilla kaq të ndjeshme dhe komplekse.

Shtoj kësaj ngritjen e evidente ekonomike në vend, atëherë ratifikohen të gjitha politikat e avancuara dhe vizionare, që në vazhdimësi i ka udhëhequr Qeveria Thaçi gjatë këtij mandati.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Skender Hyseni, në emër të Grupit.

**SKENDER HYSENI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Do të duhej dhe do të kisha dëshiruar të ishte këtu kryeministri Thaçi, apo vartësja - zëvendësja e tij Edita Tahiri, dhe ministri i Jashtëm Hoxhaj, sepse tema të cilën do ta prek sot ka të bëjë, në rend të parë, dhe kryekëput me deklaratat e tyre, bërjet dhe mosbërjet e tyre, punën dhe mospunën e tyre, e cila është duke e dëmtuar Kosovën në mënyrë të pariparueshme. Para një viti, kjo Qeveri e kishte pranuar symbyllur një referencë Rezolutës 1244, e cila amë vonë, me zhargon, u quajt fusnotë.

Atëherë, kryeministri na thoshte që ky është akt i njohjes së Kosovës Serbia. Zëvendësja e tij na thoshte që është po ashtu një akt tjetër i pranimit de fakto dhe de jure pavarësisë së Kosovës nga Serbia. Ndërkaq ministri i Jashtëm përpiquej të na bindte se pranimi i asaj marrëveshjeje, thelbësisht e dëmshme, do t'i mundësonte Kosovës anëtarësim të menjëhershëm nën mbi 40 organizma dhe nisma të ndryshme rajonale. Ai kishte harruar dhe si duket nuk e di as sot që në pjesën dërmuese të atyre nismave parakusht për t'u bërë anëtarë është të qenët anëtar i OKB-së dhe kështu ngadalë kemi ardhur te një situatë akoma më absurde.

Serbia prezanton platformë për zgjidhjen e problemit të Kosovës te ndërmjetësuesi në bisedimet Prishtinë-Beograd dhe nëse ndërmjetësuesi e ka pranuar këtë platformë, qoftë edhe teknikisht, fizikisht është e papranueshme. Sepse ndërmjetësuesi shtron tema për diskutim vetëm në prani të të gjitha palëve.

Bashkimi Evropian po tërhiqet përballë presioneve të Beogradit, në mungesë të presioneve nga Prishtina. Derisa nga Beogradi ka presion dhe Bashkimi Evropian tërhiqet edhe nga përdorimi, përkatësisht qëndrimi i mbrojtjes të integritetit territorial të Kosovës, nga Prishtina nuk ka presion mbi Brukselin dhe rrjedhimisht të gjitha nismat që Beogradi

i ndërmerr, në Bruksel e marrin dritën e gjelbër, zhvillohen, e marrin të drejtën e diskutimit dhe shkojnë më tutje.

Ndërkaq Prishtina reagon në mënyrë retroaktive. Kryeministri Thaçi dje tha që platforma serbe në thelb është antievropiane. Unë i them kryeministrit Thaçi që para se të flasë në emër të Evropës, le të flasë në emër të Kosovës, sepse ka kush të flasë në emër të Evropës, ka kush ta mbrojë Evropën. Ai dihet të flasë në emër të Kosovës. Nuk ka nevojë të brengoset kryeministri Thaçi nëse një platformë serbe është evropiane apo antievropiane. Ka kush të brengoset për këtë punë.

Ndërkaq kryeministri Thaçi do të duhet të brengosej shumë pse platforma serbe, qoftë e ka gjetur edhe një të vetmin dëgjues 'interlloputar' në Bruksel, sepse rreziku është që kjo platformë do të gjejë akoma më shumë dëgjues.

Kur është pranuar fusnota na thuhej që puna e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit është punë e kryer. Ne po e shohim që nuk është ashtu dhe sërish Qeveria Thaçi reagon në mënyrë retroaktive në konkluzionet e Bashkimit Evropian. Ka nevojë për një proaktivizëm të skajshëm, nëse duam që gjërat të mos e marrin rrugën e paktim në dëm të Republikës së Kosovës.

Dhe, unë ju siguroj, të nderuar deputetë, nuk flas as absolutisht nuk bëj politikë partiake, janë brenga reale, të cilat, ju siguroj se, nëse nuk adresohen me kohë, do të merremi në mënyrë retroaktive me pasoja tepër të mëdha që po i shkaktohen Kosovës, në mungesë të presionit nga Prishtina. Prishtina nuk bënë asnjë lloj presioni në Bruksel, ndërkohë që Beogradi...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën, në emër të Grupit.

**VISAR YMERI:** Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

E dini që me nismën e deputetit të Partisë Demokratike të Kosovës, pra të zotëri Ramiz Lladrovci, mbi 80 deputetë të Kuvendit të Kosovës e kanë nënshkruar një kërkesë, në të cilën thuhet se Kuvendi duhet ta debatohet rastin "Kiçina", rast gjyqësor ky i cili është përfolur shumë në Kosovë.

Sipas të gjitha analizave, rasti "Kiçina" njihet si një ndër padrejtësitë më të mëdha në gjyqësinë e Kosovës pas luftës. Pra, si rrallë në raste tjera, iniciativa e zotit Lladrovci e mori përkrahjen e shumicës së deputetëve, edhe të grupeve parlamentare. Gatishmëria e deputetëve për të diskutuar këtë rast ishte në nivelin më të lartë dhe kjo temë është shtyrë disa herë, e është shtyrë edhe këtë herë. Pas mbledhjes së nënshkrimeve dhe caktimit të debatit, deputeti Lladrovci ka kërkuar që debati të shtyhet pa dhënë ndonjë sqarim të qartë. Sqarimi i vetëm ishte se duhet konsultime shtesë, por nuk thuhej me kë, për çka dhe kur.

Kjo është në kundërshtim me vullnetin e deputetëve, të cilët tashmë e kanë shprehur këtë nëpërmjet nënshkrimeve. Në qoftë se shtyrja është bërë për arsye objektive, atëherë do të ishte mirë që deputeti Lladrovci t'i ndajë ato edhe me ne, mirëpo në qoftë se shtyrja është bërë për shkak të presioneve të jashtme atëherë kjo dëshmon se ka ndërhyrje, pra dëshmon edhe një ndërhyrje në punën e Legjislativit, si organi më i lartë ligjvënës në Republikën e Kosovës.

Lëvizja “Vetëvendosje” e ka të qartë ndarjen ndërmjet pushteteve, në parim. Pra, ne besojmë që për funksionimin e mirëfilltë të demokracisë dhe sistemit të kontrollit të bilancit, të fuqive të pushtetit, Legjislativit, Gjyqësorit dhe Ekzekutivit, duhet të jenë të ndara, por ky fatkeqësisht nuk është rast në Kosovë. Përveç që ka ndërhyrje të përditshme të Ekzekutivit në punën e Kuvendit, gjë që u vërtetua edhe me publikimin e përgjimeve, edhe vijat e ndarjes ndërmjet Gjyqësorit kanë filluar të lakohen, të priten dhe të mos shihen.

Si mund ta komentojmë ndryshe një rast skandaloz që ndodhi ditëve të fundit? I dënuari për krime Xhabir Zharku, ish-kryetar i Komunës, nga Partia Demokratike e Kosovës, për Kaçanik, disa herë i lavdëruar, madje edhe i falënderuar nga kryeministri i Kosovës dhe njëherësh kryetar i PDK-së, Hashim Thaçi, për punën që ai e paska kryer në Kaçanik, disa herë kishte tentuar t'i shmanget vuajtjes së dënimit, duke kërkuar shtyrje me arsyetime, secila nga të cilat ishte më banale se tjetra. Gjyqësori këtë nuk e pranoi si shenjë se ky kriminel mund të arratiset, edhe në rastin kur arsyetimi ishte se ai kishte një biznes dhe se tani ishte vlugu i punëve. Xhabir Zharku iku, jo nëpërmjet maleve të Kaçanikut, por me pasaportë të rregullt nëpërmjet aeroportit. Pra, as pasaporta nuk i ishte konfiskuar. Për t'ia dhënë vulën këtij skandali, Qeveria i bën kriminelit që të vijë në burg. Thua se është vendim vullnetar i tij për të ardhur në burg.

Rasti i Xhabir Zharkut dhe rasti “Kiçina” janë shembuj tipikë se si drejtësia po lakohet, se intervenimi i pushtetit në drejtësi është i përhershëm dhe arbitrar dhe kjo tani po reflektohet në Parlament. Në qoftë se ne nuk guxojmë ta diskutojmë rastin “Kiçina”, sepse do të shiheshin ndërhyrjet në Gjyqësor, së paku mund t'i diskutojmë këto ndërhyrje të Ekzekutivit në drejtësi. Për këtë i kemi më shumë se 80 nënshkrime, e kur vullneti i Parlamentit ekziston, do të ishte shumë mirë ta dimë se kush po ndërhyr për ta shmangur këtë diskutim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Neziraj e ka fjalën.

**XHEVDET NEZIRAJ:** Faleminderit!

Flas në emrin tim personal.

Unë sot do ta ngre një çështje në lidhje me bilancet e fundit që po bëhen në Kosovë dhe do ta ngre një çështje për komunitetin egjiptian, i cili në të gjitha raportet e fundit po del që është i anashkaluar në shumë procese, sidomos në punësimin në shumë institucione, që i takojnë edhe me ligj.

Unë do të përmend vetëm disa argumente, të cilat do ta sensibilizojnë Kuvendin dhe institucionet, të cilat duhet të ndërmarrin masa me qëllim që raporti i ardhshëm të jetë shumë më pozitiv.

Dua të them që me ligj është e paraparë që nga komunitetet joshumicë 10% të jenë të punësuar në ndërmarrje publike dhe dua të them këtu, në këtë Kuvend, se asnjë pjesëtar i komunitetit egjiptian nuk është i punësuar në PTK, në KEK, në Aeroport, edhe pse kjo është e paraparë me ligj. Nuk po e ceku se është e paraparë me ligj, por dua të jetë, tek e fundit, edhe çështje humanitare.

Një çështje tjetër që do ta them, edhe në institucionet me rëndësi, siç është Policia e Kosovës, Dogana, dhe shumë institucione tjera me rëndësi, nuk është i punësuar asnjë pjesëtar i komunitetit egjiptian. Këto po e thonë edhe raportet e Këshillit për të Drejtat e Njeriut, të Avokatit të Popullit dhe ato ndërkombëtare. Unë do të dëshiroja që në këtë vend të mos ketë shkelje të të drejtave të komuniteteve, e posaçërisht të komunitetit, të cilin unë e përfaqësoj.

Arsyeja është se po bëhen afro 5 vjet deri te pavarësia, e Kosova si shtet i pavarur nuk mund t'ia arrijë qëllimit që në disa institucione mjaft të rëndësishme të ketë të punësuar edhe pjesëtarë të komunitetit egjiptian, që do të ishte një punësim i tyre simbolik, por do ta kishte një domethënie të madhe, për arsye se komuniteti do ta ndiente veten shumë më të sigurt sikur ta kishte një numër më të madh policësh në stacionet policore të Kosovës, do ta kishte ndier veten shumë më të privilegjuar po të kishte pjesëtarë edhe në PTK, edhe në KEK, për arsye se këto janë institucionet tona, edhe të komunitetit egjiptian.

Shpeshherë komuniteti egjiptian pas luftës nuk i ka ngritur këto çështje me qëllim që të mos pengojmë në çështjet e pavarësisë së Kosovës, por tani, 5 vjet pas pavarësisë, dëshiroj që institucionet e Kosovës të bëjnë më shumë për komunitetet, të cilat janë lënë pasdore. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Ju faleminderit! Zonja Novobërdaliu, në emër të Grupit.

**SUZAN NOVOBËRDALIU:** I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Para disa muajsh, Agjencia Kundër Korrupsionit ngriti kallëzim penal kundër zëvendëskryeministrit të parë të Kosovës dhe njëherësh presidentit të subjektit politik, Aleanca Kosova e Re, zotëri Behgjet Pacolli. Kallëzimi penal u ngrit me arsyetim se kinse kishte konflikt interesi dhe mashtrim me rastin e nënshkrimit të një memorandum bashkëpunimi me shtetin e Nigerisë. Kallëzimi penal, të cilin Agjencia e ngriti, duke menduar se e kishte bazën, e i cili juridikisht ishte i pabazë, më vonë u confirmua si i tillë nga Misioni Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë - EULEX-i, duke e hedhur poshtë të njëjtin.

Deri këtu nuk do ta kritikojmë Agjencinë, përpos se nuk mund të themi se është profesionale. Pas ngritjes së kallëzimit penal, Agjencia, respektivisht drejtori i saj e zhvilloi një fushatë të orkestruar dhe të shëmtuar kundër personalitetit të zotëri Behgjet



Pacolli, duke u munduar ta denigrojë atë të qytetarët e Kosovës dhe tek elektorati i tij. Këtë e bëri gati për çdo ditë, duke dhënë deklarata në media, se në këtë mënyrë Agjencia e lufton korrupsionin.

Gati për çdo ditë e keqpërdori emrin e zëvendëskryeministrit, zotëri Pacolli. Me këto deklarime në media, zotëri Hasan Preteni, njeriu i parë i Agjencisë, ka bërë shkelje të Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit, kreu VI, të nenit 22, i cili thotë: “Zyrtarët e Agjencisë, çdo person i punësuar në të, janë të detyruar ta ruajnë si sekret çdo informacion që e kanë mësuar gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, që konsiderohet informacion sekret”. Pastaj, në kuptim të këtij ligji, informacion sekret konsiderohen informacionet në lidhje me të dhënat personale të individëve, që janë ose kanë qenë objekt i hetimit nga Agjencia, vazhdojnë paragrafët tjerë.

Kjo do të thotë që zotëri Hasan Preteni, në vend se ta respektojë ligjin dhe të heshtë, ai pothuaj për çdo ditë paraqitet në media, duke e shkelur ligjin dhe duke e reklamuar Agjencinë.

Pse e ka bërë këtë? Çfarë ka fituar prej kësaj? Për këtë, me të vërtetë nuk kam përgjigje, përpos që një gjë e di: Në një shtet ku sundon ligji, i njëjti, ose vullnetarisht jep dorëheqje, ose shkarkohet për arsyet që i ceka më lart, si dhe paguan kompensim të lartë për dëmin që ia ka shkaktuar personalitetit në fjalë.

Çka më tutje? Kush është përgjegjës për informatat e rreme, të dhëna në opinion, për mashtrim të opinionit? Kush përgjigjet për diskreditimin e personalitetit, për ndjenjat e zotëri Pacollit, i cili tërë kohën e ka ditur që është i pafajshëm, derisa tërë kohën është akuzuar nga Agjencia si fajshëm? Apo ndoshta është dashur që zotëri Pacolli tërë kohën të dalë në media, të thotë se punën e vet e kryen me nder dhe se është duke punuar për të mirën e Kosovës. Dhe, se është i pafajshëm.

Pastaj, çka të themi për gazetarin, i cili mendoj se bëri zbulimin epokal dhe e mori edhe një çmim për shkrimin më të mirë.

Prandaj, krejt në fund, u bëj thirrje institucioneve të pavarura, sidomos Agjencisë Kundër Korrupsionit që gjatë ngritjes së kallëzimeve penale të jenë më profesionale, si dhe gjatë gjithë punës ta respektojë ligjin. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

**HALIT KRASNIQI:** Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Ky vend dhe populli ynë asnjëherë nuk ka pasur arritje dhe perspektivë kaq të ndritshme. Besimi i qytetarëve ndaj institucioneve është në rritje. Në ngritjen e këtij besimi është obligim të kontribuojmë të gjithë.

Shpresa e qytetarëve për ndonjë alternativë të re është mbytur në këtë Kuvend me politikat anakronike dhe të dëmshme në emër të vizionit të ri, që nga veprimet të cilat e

dëmtonin qenësisht pozitën e Kosovës dhe imazhin e saj, nga përpjekjet për t'i zhvendosur angazhimet nga veriu i Kosovës për të trazuar pjesë tjera të saj, deri te përkushtimi për ta satanizuar Shërbimin Informativ Kombëtar, e jo praninë e recidivave të UDB-së në çdo cep të Kosovës ende edhe sot.

Shpresa dhe besimi i qytetarëve të Kosovës duhet të rritet tek ai subjekt që përbëhet nga breza protagonistësh të lirisë, të cilët nuk i konvertojnë asnjëherë parimet e tyre as me shkëlqimin e rrejtshëm të parasë, as me huret pushtetore, as nga ngazëllimi i sukseseve, as nga strategjitë obstruksioniste, e as nga veprimet obskurantiste ngado që vinë.

Kapitulli i domosdoshëm i dialogut me Serbinë - kryeministri e ka krijuar një shkëlqim të ri dhe e ka forcuar karizmin e tij në Bruksel. Sensi i tij vizionar duhet t'i diktojë dhe ta ruajë këtë shkëlqim, duke i korrigjuar resurset dhe t'i korrektojë objektivat e Qeverisë, duke i sintetizuar këto veprime gjithnjë me politikat euroatlantike.

Çdo cenim të integritetit territorial në çfarëdo forme nga këto bisedime dhe çdo shkelje e Kushtetutës së Kosovës nga kushdo qoftë në këtë proces, ndëshkimin e ka të paevitueshëm dhe të pamëshirshëm, thotë leksioni intuitiv.

Komunikimet me dy krahina të origjinës sonë - Sanxhakun dhe Luginën e Preshevës, duhet intensifikuar në nivel më të lartë. Problemet sociale duhet trajtuar më mirë se këtë vit, shërbimet shëndetësore duhet plotësuar më shumë, nevojat e pensionistëve duhet trajtuar edhe më me kujdes, ndërsa arsimit duhet ta ketë edhe më shumë kujdesin e përhershëm, sesa këtë vit.

Me satisfaksionin e punësimit të familjeve që u flijuan për këtë ditë, u ndihmojmë për ta zhvendosur koncentrimin e tyre në obligimet e përgjegjësisë. Edhe në nevojat e këtyre familjeve duhet të jemi të vëmendshëm. Nëse do të mungojë kjo vëmendje, mallkimi do të vijë nga toka, e ndëshkimi nga Zoti.

Për këtë fundvit e kam veçuar një paradoks, me djalin e Adem Jasharit, me profesion ushtarak, me Akademi Ushtarake, të përfunduar në Tiranë, tani vite të tëra i papunë! Është i pajustificueshëm ky paradoks. Ai duhet të përfshihet me ceremoni në FSK, në uniformë si oficer i lartë, ashtu siç është shkolluar dhe ashtu siç e meriton.

Pa e zgjatur dhe pa e forcuar me patetikë këtë paradoks, ju faleminderit për vëmendje dhe ju lus të keni konsideratë për të gjitha këto që i ngrita në këtë fundvit.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Demolli e ka fjalën.

**HAKI DEMOLLI:** Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetari ynë nëpërmjet votës së lirë e ka mundësinë t'i zgjedhë kandidatët për të cilët beson se do ta përfaqësojnë dhe do t'i mbrojnë interesat e tyre në mënyrën më dinjitoze.

Ata që e fitojnë besimin e popullit nëpërmjet votës demokratike mund ta kryejnë detyrën e deputetit, kryetarit të Komunës, këshilltarit komunal, për çka edhe kompensohen mjaft mirë nga shteti i Kosovës. Pra, vlerësohet se ata janë më të mirët ndër më të mirët, andaj e kanë obligim që punën e tyre ta kryejnë me përkushtim dhe nder, si në rrafshin e hartimit të ligjit, ashtu edhe në zbatimin dhe respektimin e tij.

Pra, ata duhet të jenë shembull më i mirë në sferën e sundimit të ligjit, jo vetëm për nëpunësit dhe shërbyesit civilë, por edhe për të gjithë qytetarët e vendit. Kështu të paktën është në vendet demokratike, ku të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit, por në Kosovë nuk ndodh kështu, sepse, për fat të keq, disa prej të përzgjedhurve të popullit, jo vetëm që në vazhdimësi i cenojnë dispozitat që aprovohen nga organet të cilave u përkasin, por edhe e pengojnë zbatimin e tyre në mënyrën më të vrazhdë të mundshme.

Shembull tipik i veprimit të këtillë paraqet arratisja e ish-kryetarit të Kaçanikut për shkak të ndëshkimit të të cilit edhe u mbajtën zgjedhjet e jashtëzakonshme në Komunën e Kaçanikut gjatë këtij viti.

Ikja nga vuajtja e dënimit me burg e këtij zyrtari të PDK-së jam i sigurt se do të përcillet me një varg pasojash për Kosovën, si për shembull:

Nën 1, do të kemi dëmtim të rëndë të imazhit të të përzgjedhurve të popullit para qytetarëve të Kosovës.

Nën 2, dëmtim i rëndë i imazhit të sistemit gjyqësor të Kosovës, si në vend, ashtu edhe jashtë vendit.

Nën 3, veprimi i tillë do të shërbejë si model negativ për të pandehurit dhe të dënuarit tjerë ordinerë në Kosovë, gjë që menjëherë u tregua në praktikën e rastit “Bllaca”.

Nën 4, dëmtimi serioz i imazhit të shtetit të brishtë të Kosovës në rrafshin ndërkombëtar, duke u pasqyruar si një shtet, ku jo vetëm qytetarët e rëndomtë, por edhe zyrtarët e lartë politikë i cenojnë dhe përdhosin organet dhe dispozitat ligjore të shtetit.

Andaj, kërkoj nga partitë politike dhe institucionet përgjegjëse që të angazhohen në drejtim të shtytjes së anëtarëve të tyre që t’i respektojnë ligjet e vendit tonë, si dhe që në të ardhmen kandidatët e tillë të mos i fusin në listat zgjedhore dhe të mos e mashtrojnë popullin me kandidatë që i cenojnë ligjet e vendit tonë. Faleminderit!

**KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albana Gashi e ka fjalën.**

**ALBANA GASHI: Faleminderit kryesues!**

Çështja të cilën dua ta trajtoj sot ka të bëjë me problemin e nxënësve të fshatit Kashtanjevë. Kashtanjeva, fshat ky në komunën e Shtërpçës, përveç vështirësive për mbijetesë, e ka edhe problemin e qasjes në institucionet arsimore.

Fshati Kashtanjevë është i ndarë në dy pjesë, dhe i ka gjithsej 17 shtëpi. Këto familje kanë kërkuar nga kryetari i Komunës që fëmijët e tyre ta vijnë në mësimin në shkollën fillore të Firajës. Deri më tani, këta fëmijë e kanë vijuar mësimin në shkollën e Kashtanjevës, mirëpo prindërit shprehin shqetësimin që kjo shkollë funksionon pothuajse si një institucion i pavarur, ku mund të vihet në dyshim edhe cilësia e mësimdhënies, përgatitja e stafit dhe e planprogramit mësimor.

Megjithëkëtë, për të vijuar mësimin në këtë shkollë, fëmijët duhet të përshkojnë një rrugë prej 4 kilometrave përmes rrugëve malore, ndërsa rruga lokale mund të arrijë deri 10 kilometra gjatësi, që e bën të pamundur udhëtimin deri në këtë shkollë edhe sikur të kishte mësim të mirëfilltë aty.

Nënkryetari i kësaj Komune u ka thënë qytetarëve të Kashtanjevës se transporti mund të bëhet vetëm deri në shkollën fillore të Kashtanjevës, por jo edhe deri në atë të Firajës. Qytetarët nuk u pajtuan me këtë shërbim të pushtetit lokal dhe të nënkryetarit dhe pas refuzimit, ai mori guximin ta ndërpriste qarkullimin e furgonit, i cili i transportonte fëmijët vitin e kaluar në shkollën fillore në Firajë.

Dy javët e para të ndërprerjes së transportit, fëmijët nuk e vijuan mësimin askund, por ditët e fundit ata kanë filluar të shkojnë sërish, gjysma në Firajë e gjysma në Kashtanjevë.

Sipas disa punonjësve të Administratës së pushtetit lokal, nuk ka mundësi të rilëshohet transporti nga fshati Kashtanjevë, sepse mjetet që ishin destinuar për fshatin Kashtanjevë i kaluan transportit të fshatit Biti, ndërkaq fëmijët e fshatit Kashtanjevë duhet të ecin në këmbë për të shkuar deri në shkollë.

Banorët e këtij fshati shprehin brengën e tyre, duke pasur parasysh rrezikshmërinë të cilën fëmijët e tyre mund ta hasin gjatë periudhës së dimrit, si dhe në gjatësisë e rrugës që fëmijët e tyre duhet ta përshkojnë për të shkuar deri te shkolla më e afërt, prandaj kërkesë e tyre është që sa më parë të sigurohet transporti për fëmijët e këtij fshati. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Kelmendi e ka fjalën.

**GËZIM KELMENDI:** Faleminderit i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të nderuar, Paraprakisht, para se të flas, do të informoj, edhe për hir të korrektësisë, se e di që reagimi është më vonë, ka kaluar java pothuajse, por ajo çka më bren më së shumti është krenaria apo mburrja nga disa deputetë kolegë, edhe të pozitës, edhe të opozitës, për punën që e kanë bërë në Komisionin për Buxhet e Financa. Nuk është hera e parë, sepse kjo dukuri përsëritet edhe nga mandati i kaluar, që deputetët, nga grupe të caktuara, qoftë pozita apo opozita, propozojnë amendamente në Komision dhe ato amendamente kalojnë dhe pikërisht ato amendamente kanë të bëjnë me interesat e tyre, do të thotë të vendit nga ku vijnë - qytetit, dhe është paradokse të shihen amendamente se si janë propozuar dhe kaluar për çështje sekondare për qytete, lagje e paralarje dhe për objekte të ndryshme. Do të thotë, ne kemi shumë çështje vitale të rëndësishme për Kosovën.

E kemi statusin e pazgjidhur ende të veteranëve e të dëshmorëve të luftës.

Vetëm gjatë këtij viti së paku 3 ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare e kanë vetëvrarë veten nga gjendja e rëndë sociale dhe nga kushtet e rënda në Kosovë.

Kemi rreth 17% të varfërisë në Kosovë të skajshme. Kemi pensionistë me gjendje jo të mirë, kemi qindra pacientë që kërkojnë trajtim jashtë vendit për sëmundje të rënda. Ndërsa, ne të propozojmë amendamente dhe të marrim para nga Buxheti i Kosovës, t'i alokojmë ato dhe t'i dërgojmë për interesat tona lokale qytetit nga vijmë për paralagjet dhe lagjet tona, apo për objektet sekondare, kjo nuk çon peshë.

Ky është një argument shtesë, sepse Kosova nuk duhet të ketë shumë zona zgjedhore, ngase do të kemi kështu invazion ndaj buxhetit nga zona për interesat lokale, e jo për interesat madhore të Kosovës dhe të shoqërisë ku jetojmë.

Dhe, një fakt tjetër duhet ta përmend se e dimë që Kosova prin nga vendet me shkallë të lartë të korrupsionit. Por, ajo çka u pa javën e kaluar dëshmon se jo vetëm në institucione publike vendore kemi korrupsion, por korrupsioni fatkeqësisht ndodhet edhe te vetë ne deputetët, ngase korrupsion është kur merren paratë e buxhetit dhe alokohen për vendet nga vijmë për lagjen dhe paralagjet ku jetojmë.

**KRYESUESI:** Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

**ZENUN PAJAZITI:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Pata dy çështje, njëren prej tyre po e konsumoj meqenëse në sall është edhe zoti kryeministër, edhe Qeveria. Është fjala për platformën e re serbe, e cila po shihet se ka ngjallë reagime edhe këtu në Parlament.

Është mirë që dje pati një reagim të shpejtë e të fuqishëm nga të gjitha institucionet e Kosovës dhe do të ishte mirë që para se të shfrytëzohet kjo edhe për debate e konsum të brendshëm politik, të gjitha forcat politike edhe ata që kanë mundësi dhe kapacitete të kontribuojnë në këtë proces, le të kyçen më së miri në grupin dhe ekipet që aktualisht janë të drejtuara nga Qeveria për këtë çështje.

Çështja që unë dëshiroj sot ta ngre këtu është shumë praktike dhe ka të bëjë me shfrytëzimin ose përdorimin e fishekzjarrëve. Jemi në prag të Vitit të Ri, ndërkaq kemi një varg statistikash që tregojnë se ka pasur pasoja nga shfrytëzimi i tyre. Por, ajo që vlen të theksohet është që prej marrjes së kompetencave të institucioneve vendore në vendin tonë, prej vitit 2008-2009, ka pasur 225 të lënduar me rastin e festave të Vitit të Ri, ndërkaq më 2009-2010 kjo është reduktuar në 25, pastaj 17, dhe vitin e fundit ose festën e fundit të vitit të kaluar, 19 raste. Pra, prej kur institucionet tona e menaxhojnë përdorimin e këtyre fishekzjarrëve, kemi reduktim shumë të madh të lëndimeve. Por, ajo që dëshiroj të shtroj këtu është t'i ftoj të gjitha institucionet që para se të ndodhë ndonjë fatkeqësi, meqenëse javën e fundit të vitit të gjitha tregjet në qytetet e Kosovës janë deponi e fishekzjarrëve, kërkoj nga inspektorët, pasi vitin e fundit e kemi centralizuar punën e inspektimeve, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, bashkë me komunat dhe institucionet

tjera, të ndihmojë që sheshet tona në javën e fundit të mos bëhen me krisma, me deponi të fishekzjarrëve dhe ta kemi një pamje më të mirë. Pra, u takon të gjitha institucioneve, por edhe prindërve që të punojnë me fëmijët e tyre, në mënyrë që të kemi një pamje tjetër këtë vit. Të provojmë ta kemi një pamje ndryshe, ashtu siç e bëjnë festë të gjitha vendet evropiane. T'ua lejojmë sheshet që të gjithë familjarët, gratë shtatzëna, fëmijët, pleqtë të mund të ecin lirshëm, pa u frikësuar, pa u shqetësuar dhe po ashtu të mos kemi dëme.

Ju e keni parë vitin e kaluar që edhe në vendet fqinja kemi pasur raste kur kemi pasur edhe eksplozime në mes të shesheve, ku deponi të tilla kanë qenë rrezik për të gjithë njerëzit që kanë qenë aty dhe ka pasur po ashtu dëme njerëzore dhe materiale.

Shpresoj që institucionet tona, edhe lokale, edhe ato qendrore, këtë vit të marrin masa më të mëdha e më efikase, në mënyrë që të mos i lihet vetëm Ministrisë së Brendshme ose Departamentit për Siguri Publike...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! I fundit është zoti Hamiti, nënkryetar i Kuvendit.

**SABRI HAMITI:** Zoti kryesues,  
Zoti kryeministër dhe të gjithë ministra të pranishëm,  
Kolegë deputetë,

Sot më është bërë publike dhe ka dalë në gazeta një projekt i Serbisë lidhur me Kosovën. Domethënë më nuk është tekst sekret, është tekst publik, në të cilin e kemi një rrjet kërkesash, që në esencë kanë qëllim shkatërrimin institucional të Kosovës. Po flas me terma më të shpejtë, sepse i kam vetëm tre minuta.

Ne jemi në një proces bisedimesh me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve. Serbia thotë: kusht i normalizimit të marrëdhënieve është ky projekt yni, i cili kërkon shkatërrimin institucional të Kosovës, edhe të statusit, edhe të rregullimit të brendshëm.

Meqë jemi në procesin e bisedimeve, dhe e kemi këtu edhe kryeministrin, që është njeriu që e përfaqëson direkt Kosovën, unë mendoj që Kuvendi e ka detyrim, por edhe kryeministri si dialoguesi kryesor e ka detyrim dhe është nevojë e domosdoshme që në Kuvend të bisedohet gjerë e gjatë për këto çështje, para se ta kemi një takim të ardhshëm në Bruksel, sa e di unë më 17 janar 2013. Edhe për shkak të tajmingut dhe punës së Kuvendit, mendoj që ky Kuvend duhet të dialogojë dhe të bisedoj bashkë me kryenegociatorin tonë se çka do të bisedohet më 17. Jo çka bisedohet më vonë, sepse kryeministri ka qenë shumë i saktë dhe ka raportuar pas bisedimeve, sepse unë mendoj që në këtë gjendje të re që po krijohet, me kushtëzimet që jep Serbia dhe i çon si tekste në Bruksel dhe i bën publike, Republika e Kosovës më nuk di si bisedon para se të kërkojë që ata t'i tërheqin forcat jolegjitime, forcat shtetërore të Serbisë nga veriu i Mitrovicës.

Është çështje tjetër mandej nëse bisedohet rajonalisht, mund të bisedohet për veri e për jug. Le të bisedohet pra për jugun e Serbisë, nëse bisedohet për veriu e Kosovës, ose për

veriun e dikujt në Ballkan e për jugun e dikujt. Nuk është Kosova eksperiment për ndodhitë në Ballkan dhe ky Kuvend ka përgjegjësi, po them edhe një herë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër Thaçi e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit i nderuar nënkryetar, zoti Haliti!

Të nderuar deputetë,

Unë do t'i kontribuoj diskutimit tuaj që e ngrehët edhe më herë, së bashku me zëvendëskryeministren Edita Tahiri dhe ministrin e Jashtëm, zotin Hoxhaj.

Do t'i përgjigjem natyrisht edhe interesimit, edhe tuaj, edhe të opinionit publik.

Por, fillimisht më lejoni që në emrin tim personal, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, juve të nderuar deputetë, të ju uroj festat e fundvitit, Kërshëndellat, Vitin e Ri, si dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, me të gjithë ta mirat!

Ne jemi dëshmitarë të një reagimi nervoz dhe agresiv të Beogradit ditëve të fundit. Reagime këto që kanë ngjallur edhe interesimin e opinionit publik kosovar, por në të njëjtën kohë një interesim shumë legjitim që u prezantua këtu edhe prej deputetëve. Por, nga të gjithë ata që u prezantua ky interesim dhe shqetësim, natyrisht se besoj që të gjithë janë shumë të vetëdijshëm për reagimet e Beogradit në momente të caktuara, gjithmonë për zhvillimet në Kosovë, reagim ky i një mentaliteti të politikës së vjetër serbe karshi Kosovës dhe shqiptarëve, në përgjithësi.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka dalë me qëndrimin e saj shumë të qartë, mendoj edhe skena politike kosovare, dhe unë ju falënderoj për këto qëndrime të qarta.

Por, dua të them se ne si institucione të shtetit tonë do të bashkëpunojmë ngushtë me të gjitha autoritetet ndërkombëtare, që edhe ky proces të kalohet sa më lehtë dhe të mos ketë asnjë reflektim në Republikën e Kosovës.

Projektet që prezantohen edhe sot në Parlamentin e Beogradit e të Serbisë janë projekte që thjesht nuk e kanë burimin nga dje apo sot. Janë projekte me të cilat jemi ballafaquar si shqiptarë edhe më herët, projekte që gjithmonë kanë ngjallur reagime të shqiptarët, por duhet të theksoj se pavarësisht këtyre projekteve apo elaborateve, ne kemi arritur që të shënojmë suksese dhe sot ta konsolidojmë shtetin e Kosovës.

E përmendi edhe nënkryetari tjetër, zoti Hamiti, por dua t'i theksoj disa gjëra, si do që të jetë, ne duhet t'i kemi në vëmendjen dhe kujtesën tonë gjithmonë.

Secilit nga ne i është i njohur elaborati i Garashaninit, i shekullit XIX, se çfarë qëllimi ka pasur në raport me shqiptarët.

Planet edhe të Karagjorgjeviqit, fillimi i luftërave ballkanike, planet shfarosëse kundër shqiptarëve, pastaj planet djallëzore të Nikola Pashiqit për Kosovën dhe shqiptarët, të Ivo Adriqit për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova për në Anadoll. Pastaj edhe rikonfirmimin e këtyre planeve djallëzore nga komunistët jugosllavë.

Gjithashtu projektet dhe planet e Vaso Çubriloqiçit për të vazhduar me dhunën sistematike të planeve të komunistëve jugosllavë të pas-Luftës së Dytë Botërore, të udhëhequr nga Aleksandar Rankoviç, një dhunë sistematike policore për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova dhe viset tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, d.m.th. në Maqedoni, në Preshevë, në Mal të Zi, për të vazhduar dhe për ta arritur kulmin e këtyre projekteve dhe planeve antishqiptare me memorandumun e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë të vitit '86, plan dhe memorandum ky që u përqafua nga politika e Serbisë, nga politika e Slobodan Milosheviqit, që u përpoq ta implementojë me dhunën e ushtrisë, policisë, paramilitarëve, deri në përmasa gjenocidi, në periudhën '90, '98, '99.

Unë dua të theksoj se burimi i këtij projekti, që sot prezantohet edhe në Parlamentin e Serbisë, është nga presidenti Nikoliq, i cili edhe vetë ka qenë pjesë e planit të Milosheviqit, pjesë e institucioneve udhëheqëse të Slobodan Milosheviqit. Pra, rikonfirmoj se plani i sotëm është vazhdimësi e politikës së Slobodan Milosheviqit në raport me Kosovën.

Por, e them me zotimin e plotë para jush, deputetë të nderuar, dhe para gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, që edhe ky plan do të jetë i përealizueshëm në Republikën e Kosovës. Nuk është, pra, plan i ri. Është vazhdimësi e planeve të vjetra të Beogradit në raport me Kosovën.

Por, në të njëjtën kohë, ky plan është një hap prapa nga Serbia në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë, proces ky i filluar në Bruksel, i udhëhequr prej Bashkimit Evropian dhe i mbështetur fuqishëm prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Unë dua të siguroj ju dhe të siguroj gjithë qytetarët e vendit se në asnjë rrethanë, me asnjë çmim, nuk do të ketë as autonomi, as ndarje, por ky projekt do të mbetet, përsëri e ritheksoj, në sirtarët e Beogradit, apo në dëshirat e paplotësuara të tyre në raport me Kosovën. E ritheksoj edhe sot, flas në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i konsultuar ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian, me NATO-n, se ky plan është plan kundër Kosovës, antievropian, kundër paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe në rajon.

Dhe secili prej jush, të nderuar deputetë, keni të drejtë të pyesni se cili është plani i Kosovës. Unë e ritheksoj fuqishëm edhe sot se plani i Kosovës është shumë i qartë: respektimi i plotë i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i ligjeve të Kosovës, i dokumentit të presidentit Ahtisari, vazhdimi i punës për konsolidimin dhe forcimin e shtetit të Kosovës, njohje edhe më të zgjeruar ndërkombëtare për vendin tonë dhe integrimin më të shpejtë e më të fuqishëm të vendit tonë në të gjitha institucionet relevante ndërkombëtare, duke përfshirë NATO-n dhe Bashkimin Evropian.



Prandaj, idetë që sot paraqiten në Beograd, idetë e tyre të vjetra nuk duhet të na vënë në lajthitje asnjërin nga ne.

Ndokush mund të thotë Beogradi po lëviz më shpejt, por unë ju siguroj që ata po lëvizin më shpejt drejt mbrapshtisë së tyre të re. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti nënkryetar Hamiti dëshiron t'i thotë dy fjalë.

**SABRI HAMITI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Kryeministri ynë bën referenca historike rreth planeve të Serbisë ndaj Kosovës dhe meqë e ka vokacionin e historianit dhe hyri në të, unë as nuk i shtoj, as nuk i mungoj asgjë. Pajtohem plotësisht.

Çështja është që, më në fund, edhe ky po e sheh, në situatën konkrete aktuale, që historia është mësuese e jetës, e sidomos në këto raporte të këtyre dy vendeve.

Dhe, e dyta, po e hedh në dyshim atë që ky dhe të tjerët e kanë quajtur "Po fillon kapitulli i ri Kosovë - Serbi". Unë edhe një herë po nënvizoj - Si do të fillojë kapitulli i ri Kosovë-Serbi me Nikoliqin kryetar të Serbisë, që harton dhe bën publike programe të tilla si kushtëzime të bisedime, duke iu përgjigjur ne se programi ynë është Kushtetuta e Kosovës dhe tipi Nikoliq, që është kryetar aktual i Serbisë, thotë: "E Kushtetuta jonë thotë që Kosova është brenda". Domethënë, ne jemi në një bisedë të ashpër historike me Serbinë, pa marrë parasysh çka deklarojnë, cili është programi i cilit. Kështu që edhe një herë po them - përgjegjësitë i ka edhe ky Kuvend, edhe Qeveria, në mënyrën si shkon dhe çka do të hapë më 17 janar në bisedimet me Serbinë, në Bruksel. Kjo temë është te dera, të cilën unë besoj që Kosova, po them tash, do ta marrë seriozisht, s'po them as Parlamenti, as Hashim Thaçi, si kryeministër, as grupet parlamentare, as partitë politike. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministri i Punëve të Jashtme, Hoxhaj e ka fjalën.

**MINISTRI ENVER HOXHAJ:** Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar, zoti kryesues,

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra,

Kolegë ministra,

Kryeministri Thaçi e prezantoi qëndrimin para jush, një qëndrim që është prezantuar edhe dje në mbledhjen e Qeverisë dhe besoj që nëpërmjet mbledhjes së Qeverisë është komunikuar edhe opinioni publik në Kosovë, po edhe jashtë Kosovës.

Më lejoni që në pozitën time që unë e mbaj të jem i qartë për qëndrimin që ne i kemi përcjellë pardje dhe dje, sapo është plasuar një platformë e tillë në opinionin publik, qëndrim që ua kemi përcjellë të gjitha shteteve mike të Kosovës, të gjitha shteteve që e kanë njohur, por edhe shteteve të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, nëpërmjet një dokumenti që e kemi hartuar në një formë shumë të shpejtë.

Së pari, platforma e cila është prezantuar për Qeverinë e Republikës së Kosovës është një platformë armiqësore ndaj shtetit të Kosovës.

Së dyti, kjo platformë është antievropiane, meqë është kundër paqes, stabilitetit dhe sigurisë në rajon, dhe paqja, stabiliteti dhe siguria në rajon nuk janë vetëm projekt i popullit të Kosovës, por është projekt edhe i evropianëve, edhe i amerikanëve janë projekt euroatlantik, në të cilin është investuar në këto 20 vjetët e fundit në mënyrë të fuqishme.

Së treti, dokumentet e tilla janë prodhim i një mendjeje raciste dhe kjo mendje raciste në politikën serbe e ka një kontinuitet prej shekullit XIX e deri më sot, dhe kjo mendje raciste ekziston edhe në konkën e presidentin serb, Nikoliq.

Së katërti, mendoj që Kuvendi i Kosovës nuk duhet ta promovojë kulturën e frikës, por duhet ta promovojë kulturën e një interesi shtetëror dhe interesi shtetëror duhet të kuptohet në mënyrë të qartë: Serbia ka dështuar politikisht, ka dështuar ushtarakisht dhe ka dështuar në rrafshin diplomatik në Kosovë. Dhe, sot jem shtet i pavarur dhe sovran, e nuk kem nevojë të promovojmë kulturë të frikës, por kemi nevojë që ta promovojmë interesin shtetëror.

Në politikën e jashtme, ka shtete të cilat kanë diskurs të fortë dhe ka shtete të cilat kanë parime të qarta. Dhe, shtetet të cilat kanë diskurs të fortë janë shtete të cilat përdorin vetëm gjuhë politike të fortë, por shtete të cilat kanë parime të qarta, që e dinë se çfarë donë.

Parimet tona burojnë nga Kushtetuta e Kosovës. Parimet tona burojnë nga Rezoluta që është miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe unë e ftoj Lidhjen Demokratike të Kosovës, nëse është e interesuar që ta mbrojtë interesin shtetëror, të vijë dhe ta mbrojtë interesin shtetëror në tavolinë. Të mos kultivojë diskurs gjuhësor në Kuvendin e Kosovës. Interesi shtetëror i Kosovës mbrohet aty ku duhet të mbrohet.

*(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)*

**KRYESUESI:** Fjalën e ka kërkuar deputeti Skender Hyseni.

**SKENDER HYSENI:** Faleminderit, kryesues!

Kolegu im, ministri Hoxhaj, më nxori në foltore për herë të dytë, sepse çuditërisht te diskursi i LDK-së ky sot paska parë diçka që nuk i kontribuon procesit dhe interesave të Kosovës, e kjo është e pamundur të kuptohet.

Nëse Qeveria e Republikës së Kosovës e ka kuptuar ndryshe diskursin e sotëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës, përpos si rrahje në drejtimin absolutisht të duhur, përpos si një përkrahje të fuqishme për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova, atëherë kjo Qeveri qenka në lajthitje të keqe dhe ky është lajm i keq për Kosovën, të nderuar deputetë dhe qytetarë të Kosovës.

Ju siguroj që LDK-ja nuk është në nevojë aktualisht të asnjë lloj leksioni për diskursin që do ta mbajë rreth të gjitha çështjeve fundamentale për shtetin e Kosovës dhe LDK-ja ka qenë shumë e qartë, dhe unë që kam folur në emër të LDK-së sot dhe në mbledhjen e kaluar, kur ka raportuar kryeministri Thaçi, kam qenë skajshmërisht i qartë dhe më lejoni të bëhem edhe një herë i qartë.

Nuk ka nevojë ministri Hoxhaj të na tregojë, të thotë se platforma serbe është antievropiane, sepse nuk e kemi dëgjuar ende askënd në Bruksel që ka thënë që është antievropiane.

Kryeministri Thaçi tha se ato janë plane të vjetra. Zoti kryeministër, para gati 20 vjetëve unë kam bërë libër me të gjitha ato elaborate që ju i përmendët.

Janë plane të vjetra, por..

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Regjia, edhe gjysmë minute!

SKENDER HYSENI: ...dëgjues të rinj të këtyre projekteve të vjetra dhe mos rastësisht bëhen projekte të reja, duke gjetur edhe dëgjues të rinj. Këtu është rreziku dhe për këtë tërhuoqa vërejtjen. Nuk dola këtu për të bërë politikë partiake, zoti ministër Hoxhaj, sepse në çështje kaq të rëndësishme të Kosovës unë nuk bëj politikë partiake.

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Ministri Hoxhaj!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Në çfarë forme dëshmohet që një grup politik nuk bën politikë të ngushtë partiake grupore? Nëse e mbështet me të gjitha mjete një proces, i cili është vendimtar, që njëherë e përgjithmonë ta përmbyllë një kaptinë të errët të historisë ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, një kaptinë e cila është përcjellë me gjenocid të ushtruar mbi qytetarët e Kosovës.

Ne e kemi pasur një rezolutë, që është miratuar nga ky Kuvend i Kosovës. Ajo rezolutë është mbështetur edhe nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Prandaj, edhe reagimi im ishte komplet në frymën e interesit shtetëror, po ia them edhe profesor Sabri Hamitit, meqë ma merr mendja që edhe ai, sidomos diskursin dhe analizën e diskursit e kupton jashtëzakonisht mirë.

Nëse LDK-ja është e interesuar që ta mbrojë interesin shtetëror të Kosovës, duhet ta mbështesë fuqishëm procesin dhe të jetë pjesë e procesit. Çdo që flitet në këtë Kuvend vetëm për konsum të brendshëm, është thjesht konsum i brendshëm.

Po ashtu, dua të ju them që s'ma merr mendja që çdo qytetar i Kosovës, jo vetëm anëtarët e Qeverisë, jo vetëm unë si ministër i Punëve të Jashtme, mund të jemi naivë në politikën

e jashtme. Ajo se çfarë ne kemi mësuar në 20 vjetët e fundit, por edhe më gjatë - naiviteti - nuk mund të jetë pjesë, ose kriter, ose mënyrë e të të kuptuarit të politikës së jashtme.

Po, ashtu në këto 20 vjet ne kemi lëvizur shumë përpara se e kem respektuar edhe një parim tjetër - mosdorëzimin. Ne do të punojmë që ta ndërtojmë shtetin e Kosovës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Edhe gjysmë minute për ministrin e Jashtëm, Hoxhaj!

**MINISTRI ENVER HOXHAI:** Kështu që nëse Lidhja Demokratike e Kosovës nuk përfaqëson interes grupor, por shtetëror, shteti i Kosovës përfaqësohet dhe interesi i tij mbrohet në procesin e normalizimit të relaksioneve në tavolinë, në Bruksel.

Prandaj, unë e ftoj Lidhjen Demokratike që ta dëshmojë me vepër, ta dëshmojë me prani se po e mbron interesin shtetëror të Kosovës.

**KRYESUESI:** Ju lutem shumë, zotërinj deputetë, Unë jam në pozitën që më duhet t'i them dy fjalë, sepse nuk e kam këtu dikë ta marrë këtë karrige, në mënyrë që të flas poshtë.

Zotëri ministri Hoxhaj foli dy herë për diskursin, dhe diskursin gjuhësor e ceku në kuptimin e keq. Unë, meqë po përzihet në fushat që edhe ashtu mund të mos i dijë mirë, duhet t'i tregoj që diskursi është gjithmonë gjuhësor. Ka diskurs me hedhje duarsh edhe shenja, por atë e bëjnë shurdhmemecët. Diskursi është gjithmonë gjuhësor. Është tjetër punë nëse ky mendon çka thuhet e çka bëhet. Atëherë jemi në pozita tjera dhe mund të interpretojmë.

Sa i përket partisë, nuk është vendi që t'u jepen detyra grupacioneve tjera në politikë. Harrojeni! Ju jeni në pushtet. Flitni si Qeveri. Puna tjetër është punë tjetër dhe nuk është mirë që bisedimet të derivojnë nga një problem kaq i madh, që nuk është për sot, por na pret. Në replika "bëni edhe ju kështu, se bëheni të mirë". Kjo, fundi i fundit, nuk e ka detyrë askush akujt t'i thotë.

Fjalën e ka kërkuar Shaip Muja.

*(Ndërhyrje, dikush nga salla: A kemi debat, a çfarë është kah bëhet?!)*

Veç një moment! Lexojeni Rregulloren shumë mirë, se jeni deputetë! Kur deklarojnë kryeministri dhe Qeveria, e jemi në fazën e deklaratave të Qeverisë, deputetët e marrin të drejtën e ushtrimit të së drejtës së komentit, sipas nenit 49. Merreni, hapeni, shiheni! Muja e ka fjalën.

**SHAIP MUJA:** Zoti kryesues, faleminderit!

Unë desha për informacion të kuptoj nëse e kemi filluar një debat, sepse ju jeni kryesues dhe po lejoni me nga gjysmë minute dhe keni filluar t'i lejoni edhe replikat.

Unë mendoj që është shqetësuese vërtet ajo që thuhet për perceptcion publik nga qëndrimet e fundit të Serbisë. Mirëpo, nga realiteti, unë mendoj që në deklaratat e tilla dhe konkluzionet të cilat Serbia i jep, ato kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë permanente, mirëpo në praktikë nuk mund të jetësohen.

Prandaj, para vitit të ri ato do të ngrihen, sepse do të ketë edhe temperatura të ulëta dhe unë mendoj që nëse mendojmë të bëjmë debat, ju si kryesues, mblihduni si Kryesi, dhe mund të bëjmë debat. Nuk është problem. Por jo të keqpërdoret pika e rendit të ditës për deklarime 30-minutëshe jashtë rendit të ditës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Edhe një herë! Mua po më vjen keq që deputetët, kur s'u jepet rasti të flasim ankohen, e tash ankohen pse po u jepet rasti, në bazë të nenit 48, pas deklaratës së ministrave. Si të doni ju. Kur të doni e ndalim. Fjalën e ka kërkuar Ismet Beqiri.

**ISMET BEQIRI:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Nuk ka nevojë ta përsëris seriozitetin që e ka LDK-ja karshi zhvillimeve dhe vetë fakti që ne e kemi përkrahur një rezolutë në Kuvendin e Republikës së Kosovës për procesin e bisedimeve e tregon seriozitetin e saj. Por, kjo nuk nënkupton në asnjë mënyrë që ne s'do t'i themi, ose s'do t'i shprehim shqetësimet tona karshi zhvillimeve që janë aktualisht.

Zoti Hoxhaj, Parlamenti i Kosovës është për këtë punë dhe këtu duhet ngrehur këto shqetësime, edhe nëse nuk bëhen asnjëherë realitet ato që i mendon Serbia, për çka të gjithë duhet të punojmë, por të na mohohet t'i themi shqetësimet tona - kjo me të vërtetë është absurd. Unë e kam një lutje: mos e shtroni në formën e dilemës nëse LDK-ja është për mbrojtjen e interesave të shtetit, nëse LDK-ja e mbështet këtë proces, apo jo. Mendoj që kjo retorikë nuk çon peshë për Lidhjen Demokratike të Kosovës, sepse absolutisht e keni huq adresën dhe nuk është vendi që ju të na tregoni se çfarë ne duhet të bëjmë.

Por, po ashtu po jua them - përkrahja karshi rezolutës ose për rezolutën nuk do të thotë në asnjë mënyrë që ne s'do t'i ngremë shqetësimet tona dhe nuk do ta përkrahim absolutisht asnjë të keqe që i vjen vendit nga bisedimet deri dje të ashtuquajtura teknike, tash politike. Prandaj, ju as s'e keni këtë të drejtë dhe as këtë mundësi të na mohoni që ta shprehim shqetësimin tonë. Dhe si Lidhje Demokratike e Kosovës mendoj që mbi dekada kemi dëshmuar se dimë edhe të punojmë, por edhe ta ndërtojmë shtetin. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Visar Ymeri e ka fjalën.

**VISAR YMERRI:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Meqenëse tash nisi debati për këtë pikë, atëherë është ndërhyrje më shumë në këtë që po diskutohet se sa koment dhe pyetje.

Duhet ta kemi të qartë një gjë, domethënë e keqja e këtij dialogu, që është paralajmëruar shumë kohë më parë nga Lëvizja "Vetëvendosje", nuk ndodh për shkak të mungesës së pjesëmarrjes së mjaftueshme të njerëzve që po shkojnë në këtë dialog. Dorën në zemër, bile kemi pa një interesim të pasohq edhe të disave që nuk u takon fare të jenë aty. Problemi është që ky dialog ka nisur dhe po vazhdon në korniza të gabuara. Pra, nuk

është një dialog i cili vjen pasi Serbia t'i ketë plotësuar disa kushte ndaj Kosovës, të cilat do ta pamundësonin pastaj prezantimin e këtyre planeve për ndarjen e Kosovës, siç po bën ajo.

Kushtet që i ka shtruar Lëvizja “Vetëvendosje”, e të cilat janë përqeshur në mënyrat më banale nga kjo Qeveri dhe nga disa deputetë të këtij Kuvendi, tash besoj që e kanë kuptuar edhe këta që do të kishin qenë e vetmja mënyrë se si do të hapej mundësia për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

U tha këtu edhe nga ministri Hoxhaj që ta mbyllim një kaptinë të errët me një shtet, i cili edhe vetë e vlerësoi që vazhdon të jetë armiqësor ndaj Kosovës për shkak se platforma e saj na qenka armiqësore, vazhdon të jetë racist ndaj shqiptarëve dhe vazhdon të jetë antievropian, për shkak se qenka kundër paqes.

E pra, si normalizohen marrëdhëniet me një shtet të tillë? E, normalizimi i marrëdhënieve me racizmin, është pranim i racizmit. Normalizimi i marrëdhënieve me armiqësinë, është pranim i armiqësisë. Nuk është e kundërta. Normalizimi i marrëdhënieve me Nikoliqin sot, nuk e bën Nikoliqin më të mirë. Përkundrazi, do t'ia rrisë atij apetitet për shkak se është dëshmuar deri tash në secilin proces negociator.

Sa më i mirë që të jesh me Serbinë dhe sa më shumë që ta ledhatosh Serbinë, aq më e keqe dhe më e egër bëhet ajo ndaj nesh. E kjo po dëshmohet edhe tash. Dhe këtë ledhatim po ja bëni ju, si Qeveri. Pra, mos u mundoni tash ta shpërndani fajin me atë se meqë edhe ju nuk po vini, ne tash po e bëjmë si po e bëjmë, dhe po e bëjmë gabim.

Një çështje tjetër që desha ta ngre karshi kësaj, është që dialogu me Serbinë nuk është interes madhor i Kosovës, siç po e përmendin ju. Ndërtimi i shtetit të Kosovës, i një shteti të fortë, bazuar në parimet universale të së drejtës dhe lirisë së popujve, është interesi madhor dhe kjo do të kishte qenë parimi i vetëm i pranueshëm për të gjithë. Por, jo dialogu me Serbinë. Pra, në këtë drejtim, nëse vërtet mendoni edhe thoni që duhet të punojmë bashkërisht për interesin madhor të Kosovës, atëherë po. Ejani të punojmë bashkërisht për interesin madhor të Kosovës. Mirëpo, ky interes madhor i Kosovës po shkelet pikërisht nëpërmjet këtyre proceseve negociatore, të cilat Kosovën po ia nënshtrojnë Serbisë, si dhe të drejtat tona kolektive në dialogun me Serbinë.

Pra, është një këndvështrim ndaj politikës, i cili është kthyer me kokë teposhtë. Nuk niset nga të drejtat dhe rrjedhimisht fuqizimi për t'i realizuar ato të drejta dhe pastaj njëlloj barazie në dialog, por niset nga dialogu, duke shpresuar që ndoshta ndonjëherë dialogu do të na i prodhojë këto të drejta. Me kë? Me armikun, racistin edhe atë që antipaqe. Pra, kjo është korniza e gabuar, të cilën, pavarësisht edhe nëse shkojnë 120 deputetë në dialog, nuk do të mund ta rregullojnë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Kryeministri i Kosovës, zoti Thaçi e ka fjalën.

**KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar Hamiti!

Pasi u hap, mund të themi debat, në këtë pikë të rendit të ditës, që nuk do të duhej të përfshihej si debat, por më tepër si opinione të lira, sido që të jetë, pasi adresimet po shkojnë në drejtim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me gjithë qëndrimin shumë të qartë shtetëror, kushtetues, ligjor, por është vullneti i qytetarëve të Kosovës nga Qeveria e Kosovës, në raport me planin e ri të Serbisë, edhe ne si Qeveri do t'i kishim opinionet tona edhe sa i përket fjalimit të Demollit, të Beqirit, të ish-ministrit zoti Hyseni, të deputetëve të PDK-së, të "Vetëvendosjes" e të tjerëve.

Prandaj, mendoj se ose ta marrë një drejtim ky diskutim, i nderuar nënkryetar i Parlamentit, ose si Qeveri jemi të gatshëm të hapim debat si pikë e veçantë e rendit të ditës për këtë çështje.

**KRYESUESI:** Unë po përpiqem t'i përmbahem Rregullores strikt dhe absolutisht në çdo pikë e presje i jam përmbajtur. Të drejtën e fjalës e ka edhe Myzejene Selmani. Dy minuta.

**MYZEJENE SELMANI:** Përshëndetje nënkryetar i Kuvendit,  
Përshëndetje për kryeministrin, për Kabinetin qeveritar,  
Përshëndetje për deputetët,  
Më duhet të ndalem vetëm në dy pika.

Duke marrë parasysh se u theksua edhe këtu se Kuvendi i Kosovës e ka miratuar një rezolutë, e cila e përkrah Qeverinë në dialogun me Serbinë, por nuk kemi çka të presim diçka më të mirë nga Serbia, përkatësisht nga Nikoliqi.

Ne si Kosovë e kemi pasur rastin edhe në Rambuje dhe në dialogun e Vjenës për pakon e presidentit Ahtisari, për pavarësinë e Kosovës e kemi rastin edhe tash si subjekte politike, si qytetarë të Kosovës, të tregojmë unitet ndaj presidentit Nikoliq dhe ndaj shtetit serb, se ne jemi së bashku dhe dimë të menaxhojmë me shtetin tonë dhe dimë të bëjmë politika karshi BE-së dhe karshi vendeve, të cilat kanë mbetur akoma në kohën e komunizmit.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kalojmë në pikën e dytë:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Vjosa Osmani, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputetja nuk është e pranishme.

Deputetja Vjosa Osmani, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Deputetja nuk është e pranishme.

Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Ramë Buja. A është Afrimi këtu? Nuk është.

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Deputetja është këtu, por ministri nuk është. Deputete, do ta shtrosh pyetjen? Deputetja e ka fjalën.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, kryesues!

Pyetja të cilën ia kam parashtruar ministrit Rexhepi është se mbi cilën bazë ligjore po implementohet i ashtuquajti IBM në zonat në kufij me Serbinë dhe a është bërë demarkacioni. Mirëpo, meqë ministri nuk është këtu, pres përgjigje në seancën e ardhshme, ose përgjigje me shkrim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja deputete!

Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Urdhëroni!

**SALIHE MUSTAFA:** Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dihet se në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ekzistojnë zyrat e punësimit dhe zyrat e aftësimit profesional të punëkërkuësve.

Pyetja ime për ministrin është: Sa punëkërkuës kanë marrë shërbime në zyrat e punësimit, si dhe sa janë trajnuar në kuadër të zyrave të aftësimit profesional? Sa punëkërkuës janë trajnuar?

**KRYESUESI:** Para se të pyetni, i lus deputetët, do të kemi punë me rendin e ditës pas kësaj, prandaj qëndroni në sallë se e kemi një propozim. Zoti ministër, e ke fjalën.

**MINISTRI NENAD RAŠIĆ:** Hvala gospodine potpredsedniće!

Poštovani zamenici premijera,

Kolege ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Na osnovu informacije koje mi posedujemo, i vrlo je bitno da se ngalasi da su to najnovije informacije, i to je deo takozvanog SIMPT-a, to je novi program koji je imao za cilj da integriše, odnosno da okupi sve one podatke koje smo imali od samog formiranja ministarstva 2002. godine, pa sve do danas, i gde je vrlo bitno da se naglasi da broj registrovanih nezaposlenih lica kod nas u Ministarstvu za rad je krajem oktobra 2012. godine bio 256 766 osoba, što je od toga 101 hiljada aktivnih. Ovaj ostatak razlike od 150 i nekoliko hiljada je pasivnih. Naglašavam još jednom zbog toga što se više puta ove brojke tako zloupotrebljavaju, ili drugačije se referišu, gde se priča i o brojkama od 350 hiljada, od nezaposlenosti 48-50% , ali ja opet ponavljam, mi imamo dokaza, odnosno registrovanih 256 hiljada, od toga 101 hiljada aktivnih, koji se redovno javljaju u naše centre za zapošljavanje.

U toku 2012. godine je registrovano i savetovano 20 559 lica. Zabeleženo ili evidentirano preko našeg centara za zapošljavanje 8 630 slobodnih radnih mesta. Ono što smo mi uradili u posedovanju, i to je jedna brojka, koja je maltene uvek slična svake godine, bilo je 7 116 lica, odnosno 7 116 radnika zaposlena kroz naše kancelarije i na treninzima je ukupno bilo 2 543 lica, odnosno treniranih ljudi, koji su bili učesnici svih naših tih 34 projekata različitih kvalifikacija koje imamo.

Naglašavam i što se tiče te kvalifikacije, preko našeg centara, da 65% ljudi, 65% naših treniranih se zaposluje odnosno nađu zaposlenje odmah u periodu od 6 meseci posle



samog tog treninga. Što znači da i to ima jedna dobra pozitivna strana, gde ljudi koji god prođu kroz naše trening centre, da se kroz jedno određeno, odnosno relativno kratko vreme zapošljavaju.

Postoji jedan, da kažem značajni možda pad tih broja nezaposlenih, to je ono što se...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Deputete, a ke pyetje shtesë? Jo. Faleminderit! Deputetja Time Kadrijaj pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputete, ministri nuk është këtu, do ta bësh pyetjen? Po.

TIME KADRIJAJ: Pyetja që kam dashur t'ia bëj sot ministrit ka qenë se një grup ekspertësh të Shëndetësisë kanë bërë ankesë dhe i kanë denoncuar shkeljet ligjore që janë bërë në Qendrën Klinike Universitare dhe në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi. Ministri është zotuar se do ta dërgojë një auditor për t'i shikuar a janë të vërteta ato shkelje.

Deputetë, me këtë kam dashur ta verifikoj para jush dhe para qytetarëve të Kosovës se gjendja e rëndë në Shëndetësi nuk është veç për shkak të buxhetit të vogël, por edhe për shkak të keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit të detyrave zyrtare.

Pyetjen shtesë do ta bëj kur të jetë i pranishëm ministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Zonja Bytyçi, e ke fjalën.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Duke e pasur parasysh faktin se me legjislacionin në fuqi është përcaktuar që çdo i 50-ti i punësuar duhet të jetë person me aftësi të kufizuara, kërkoj nga ju, zoti ministër, që të më njoftoni se sa është numri dhe përqindja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës?

KRYESUESI: Zoti ministër Rashiq, e ke fjalën.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsedavajući.

Hvala gospođo Bytyçi za pitanje!

Na žalost, u ovom momentu ne postoji neka zvanična i pouzdana statistika koliko je nezaposlenih, koliko je odnosno zaposlenih ljudi sa ograničenim sposobnostima. Ja imam neke osnovne informacije, koje smo samo preko našeg ministarstva mogli da omogućimo. To je ono što imamo mi kao jedna institucija, kao ministarstvo koja poštuje zakon od 2% zaposlenih osoba sa ograničenim sposobnostima i kod nas je već 46 ljudi zaposleno, dok u drugim institucijama nismo mogli da dođemo do pouzdanih informacija.

Ali da nije sve tako crno, dokazuje i usvajanje osnovnog inicijalnog dokumenta juče na sednici Vlade, gde smo mi napravili preduslove za pravljnje jednog zakona koji će biti namenjen osobama sa ograničenim sposobnostima, u kome će svaki privredni subjekat, svako preduzeće biti u obavezi, ukoliko ne bude u mogućnosti da zapošljava ljude, zato što imamo različite tipove firmi, gde negde verovatno nije firma u mogućnosti da angažuje ljude koji su sa ograničenim sposobnostima, pa će oni zbog toga biti dužni da uplate takozvanu kompenzaciju za neispunjavanje tog dela zakona. A mi ćemo tim istim sredstvima, koja budu bila uplaćena u posebnom fondu, da koristimo baš za stimulisanje zapošljavanja ljudi sa ograničenim sposobnostima.

Takođe, još jedan novi projekat, koji ćemo ove godine sprovesti, to je pilot, biće u dve opštine finansiran, to je takozvani socijalni inkubator. Taj socijalni inkubator će imati jednu firmu, socijalna kompanija, koja će biti namenjena baš za ljude sa ograničenim sposobnostima. Inače je predviđeno da u tim minifirmama, minisocijalnim inkubatorima ima negde oko 20 zaposlenih, uglavnom kažem još jednom osoba sa ograničenim sposobnostima.

Tako, konkretan odgovor na pitanje nemamo, tačnu pouzdanu statistiku koliko može biti na celom nivou Kosova, ali ovim zakonom i onom inicijativom koja je od juče usvojena u Vladi, mislim da će biti i to regulisano, zato što će poslodavci biti u obavezi da ukoliko nemaju takve zaposlene da to prijave i da za to naplaćuju nadoknadu. Hvala!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti ministër! Zonja deputete Bytyçi, ke pyetje shitesë? Urdhëro, deputetja Bytyçi!

**KYMETE BYTYÇI:** Faleminderit, zoti ministër!

Te unë, po ashtu edhe në takimet që kemi pasur me Komisionin Parlamentar, kanë ardhur shumë ankesa, si nga individë, po ashtu edhe nga OJQ-të, të cilat deklarojnë se kjo as për së afërmi nuk është plotësuar, pra ky kriter, jo vetëm në sektorin privat, por po ashtu edhe në sektorin publik.

Zoti ministër, unë kam kërkuar edhe nga ministri i Administratës Publike, po ashtu edhe nga ju, pse i ikni kësaj çështjeje, kësaj kategorie të njerëzve? Nuk e tregoni numrin dhe statistikën e saktë të këtyre kategorive të njerëzve të Republikës së Kosovës?

**KRYESUESI:** Ministër, e ke fjalën.

**MINISTRI NENAD RAŠIĆ:** Kao što rekoh, iako smo verujte juče kontaktirali sve relevantne institucije, stvarno sam hteo i kao odgovor vama na pitanje a i zbog naših samih informacija da znamo tačan broj, ali u ovom momentu kažem, to nije bilo moguće. Ali, ponavljam još jednom, ovaj zakon koji je bio predložen juče, koji će doći i kod Vas naravno, će biti vrlo striktan i precizan oko toga.

Tako da od usvajanja tog zakona, ja sam absolutno siguran da ćemo imati i statistiku i da ćemo moći da im omogućimo, ne da bude samo zaključak – imamo statistiku i to je to, ne nego imamo statistiku, imamo i način kako ćemo dalje da im pomognemo i taj fond, koji

može da bude skroman ali će verovatno vremenom da se uvećava, koji će takođe moći da bude usmeren baš prema licima sa ograničenim sposobnostima. Hvala!

KRYESUESI: Deputeti Goran Marinković, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Poštovani poslanici,

Poštovani ministre,

Posle godinu dana od kako je kompanija KEK potpisala sporazum sa opštinom Gračanica oko izgradnje novog dalekovoda, koji bi trebalo da napaja naselja u opštini Gračanica, koji imaju problem oko redovnog snabdevanja električnom energijom, od dogovorenog urađeno je samo to da su postavljeni stubovi, koje je opština platila.

Građani u opštini Gračanica su i dalje ostali pod restrikcijama iako je procenat naplate gotovo 100%. Gospodine ministre, radi vaših podsećanja, moram napomenuti da ste meni i svim poslanicima ovog visokog doma, rekli da će taj problem biti rešen do kraja 2011. godine, sada smo na kraju 2012 a problem nije rešen.

Na pitanja meštana zašto su i dalje izloženi restrikcijama, iako redovno izmiruju obaveze, koje imaju prema kompaniji KEK, nadležni su nam dali odgovor da smo priključeni na dalekovod na koji su priključeni i neka nasilja iz druge opštine, koja ne ismiruju svoje obaveze i tako da oni moraju da isključuju ceo dalekovod.

Pitanje: Kada će radovi na dalekovod, koji su započeti pre više od godinu dana da se završe i na taj način kompanija KEK izvršiti deo svojih obaveza prema opštini Gračanica i prema građanima u toj opštini i na taj način zaštititi prava i interesa potrošača?

KRYESUESI: Ministri Beqaj e ka fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Sigurisht, që ata të cilët e dinë mirë serbishten mund të përgjigjen edhe serbisht, sepse është tradita në pyetje.

Më lejoni që i nderuar deputet, t' ju rikujtoj se një pjesë e këtij largpërçuesi tashmë është ndërtuar, ka mbetur edhe një pjesë diku rreth 500 metra. Dhe, ky largpërçues ka qenë në gjatësi prej 17,5 kilometra i gjatë. Gjatë kohës kur është bërë implementimi i këtij largpërçuesi, i investimeve pra, kemi një kalim të konsumatorëve të fshatrave: Shushicë, Dobratin, Gushtericë e Epërme si dhe Livagjë, në largpërçuesin ekzistues të Graçanicës dhe kjo nuk ka mund të realizohet, sepse ka pasur një mbingarkesë të cilën nuk ka mundur ta bartë.

Pra, investimet kanë filluar, ato janë në proces në realizim e sipër, por ka dalë si nevojë shtesë për investime shtesë dhe ju e dini këtë, sepse kjo është diskutuar edhe me kryetarin e Komunës së Graçanicës dhe iu është shpjeguar dhe ky investim shtesë është duke ndodhur gjatë këtyre ditëve. Pra, flasim për dy kilometra shtesë të largpërçuesit, i cili do të mundësonte që edhe këto fshatra të bartin në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa ndonjë

problem, qarkullimin e mirë të energjisë elektrike dhe normalisht të bëhet një furnizim sa më cilësor.

Prandaj, sigurisht që ky është në proces e sipër dhe kam informata që kryetari i komunës është takuar tanimë me KEK-un dhe i kanë harmonizuar të gjitha qëndrimet, për investimet shtesë të cilat është dashur të bëhen për KEK-un. Pra, investimet kanë filluar, ato janë në përfundim e sipër. Gjatë realizimit teknik është parë që duhen investime shtesë, është marrë vendimi për investime shtesë dhe ato investime janë duke u realizuar. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Deputeti Marinković, ke pyetje shtesë?

**GORAN MARINKOVIĆ:** Da, imam dodatno pitanje.  
Gospodine ministre, nadam se da će to da se sigurno realizuje. Imam dodatno pitanje.

Na računima građana stoji i dalje stari dug, sa kojim su građani bili bili zaduženi kada su potrošači potpisivali ugovore sa kompanijom KEK. Prilikom potpisivanja ugovora bilo je dogovora da ukoliko građani izmiruju svoje obaveze, stari dug će biti izbrisan. To još nije urađeno.

Kada će kompanija KEK izbrisati dugovanja građana, to jest stari dug?

**KRYESUESI:** Ministri Beqaj e ka fjalën.

**MINISTRI BESIM BEQAJ:** I nderuar deputet,  
Mua më vjen keq t' ju them, por unë nuk merrem me çështje operative të KEK-ut. Sigurisht, pyetja lidhur me borxhet e vjetra dhe detajet e marrëveshjes unë nuk i di. Detajet e marrëveshjes i din kryetari i komunës së bashku me KEK-un, por në pyetjen tuaj, të cilën e keni ngritur lidhur me atë se a janë duke u bërë investimet ose jo, unë dhashë përgjigje, ndërsa sa i përket borxheve, kjo është marrëdhënie komerciale në mes të kompanisë dhe konsumatorëve dhe kjo marrëdhënie komerciale duhet të zgjidhet përmes tyre dhe në bazë ligjore.

Prandaj, në këtë kontekst Ministria e përkrah zgjidhjen në bazë ligjore të marrëveshjeve kontraktuale ndërmjet konsumatorëve dhe kompanisë.

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti ministër! Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Buja. Tash është edhe deputeti këtu.

**AFRIM KASOLLI:** Faleminderit, kryesues!  
Gjendja e rëndë si dhe mungesa e cilësisë akademike, që ka përfshirë Universitetin e Prishtinës, krahas shumë faktorëve, nuk ka dilemë se është edhe pasojë e mungesës së literaturës adekuate, bashkëkohore në rrafshin shkencor edhe në gjuhën shqipe.

Përkthimi i kësaj literature dhe pasurimi i Universitetit të Prishtinës me libra nga autorë të huaj, të cilët ofrojnë informacion adekuat mbi zhvillimet shkencore, konsiderohet jetik,

për tejkalimin e kësaj gjendjeje. Madje, thuhet se në shkurt të vitit 2010 ishte arritur edhe një marrëveshje ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe Agjencisë së Republikës së Maqedonisë, për botimin e disa teksteve, të cilët janë përkthyer për studentët shqiptarë në Maqedoni. Mirëpo, që nga ajo kohë e deri më tani nuk është arritur asgjë në konkretizimin e kësaj marrëveshjeje.

Prandaj, pyetja është: Sa ka qenë kostoja financiare e këtij projekti dhe pse ka dështuar botimi i këtyre veprave edhe në Universitetin e Prishtinës?

KRYESUESI: Ministri Ramë Buja, e ka fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar kryesues i Kuvendit, Të nderuar kolegë ministra, zëvendëskryeministër, I nderuar deputet Kasolli, Faleminderit, për pyetjen e bërë, sepse në fakt kjo çështje duhet të sqarohet para opinionit dhe studentëve dhe të tjerëve që janë të interesuar të studiojnë, vërtet. Se, në mediat e shkruara është bërë një keqinterpretim, për të mos thënë një dezinformim, se gjoja rreth këtij projekti nuk është bërë asgjë.

Unë po ju them që rreth këtij projekti që rreth këtij projekti është... ky projekt është realizuar në fakt, ajo ana paraprake dhe tash është në realizim material dhe konkret, sepse në fakt, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Universiteti i Prishtinës kanë nënshkruar Memorandumin e mirëkuptimit për blerjen e librave shkencorë për nevojat e Universitetit të Prishtinës dhe jo vetëm për Universitetin e Prishtinës, sepse do të merremi vesh që t'i shpërndajmë edhe në universitetet tjera publike, ku kanë nevojë, në bazë të një formimi të një komisioni.

Departamenti i Prokurimit në MASHT, duke u bazuar në të drejtën autoriale, ka zhvilluar procedurat e prokurimit në procedurën e negociuar dhe ka bërë një kontratë. Komisioni vlerësues ka qenë në përbërje të MASHT-it dhe të UP-së. Duke u bazuar në rezultatet e negociimit Departamenti i Prokurimit i MASHT-it ka lidhur kontratë më 2.10.2012 me Shtëpinë Botuese "Tabernakul" të Shkupit, në vlerë prej 3 milionë e 385 mijë e 324 euro.

Furnizimi ka të bëjë me blerjen e titujve shkencorë, duke përfshirë fushat e mjekësisë, shkencave të natyrës, ekonomisë dhe shkencave shkencore më pak. Afati i furnizimit me libra është brenda 24 muajve, në bazë të marrëveshjes. Sipas memorandumit, MASHT-i dhe UP-ja do të bëjnë kompensimin e mjeteve financiare për blerjen e librave shkencorë për nevoja të studentëve, nga buxhetet e tyre.

Domethënë, nuk do të ngarkohet buxheti i studentëve, andaj po ju them edhe një saktësi, që 150 tituj, saktë që është diskutuar edhe në këtë Kuvend për këta tituj, janë në rrugë për t'u realizuar. Besojmë që në javën e fundit të këtij viti do të vijë një kontingjent i këtyre librave dhe pastaj do vazhdojë realizimi në 24 muajt qysh jemi marrë vesh në atë memorandum. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Zoti Kasolli, ke pyetje shtesë? Jo, s'ka pyetje. Faleminderit!

*(Ndërprerje e shkurtër)*

Në sallë kemi 67 deputetë. Po kalojmë në diskutimin për rendin e ditës.

Një grup deputetësh, në krye me Flora Brovinën, kërkuan sot që një rezolutë që quhet partneriteti për ndryshim-fuqizimi i gruas, që është paraqitur në procedura të rregullta në Kuvendin e Kosovës është mirë, për të mos thënë është edhe e domosdoshme dhe e kërkuar, që të kalojë në këtë seancë.

Unë atëherë, ju ftoj që të votoni, domethënë po votojmë për ta futë si pikë të rendit të ditës të seancës së sotme.

Kush është për? Faleminderit! A ka kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Domethënë, Kuvendi vendos që Rezoluta që quhet Partneriteti për Ndryshim-Fuqizimin e Gruas, që ka një tekst këtu, do të votohet sot si pikë e fundit e rendit të ditës. Prandaj, e ftoj administratën e Kuvendit që rezolutën brenda kësaj kohe, derisa të vijë në rend të ditës, t'ua ofrojë përpara të gjithë deputetëve, që ta shohin tekstin vetë.

Kalojmë tutje, në pikën e tretë të rendit të ditës:

### **3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 13 dhjetor 2012**

Deputetë të nderuar, a ka kush vërejtje? Kërkoj aprovimin e procesverbalit! Faleminderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? S'ka.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat**

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

E ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI:** Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që para jush të paraqes sot për miratim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit numër 03/L-199 për gjykatat.

Më lejoni, të nderuar deputetë, të them se këtu është fjala vetëm për një nen apo për një amendament, që ka të bëjë me vazhdimin e Ligjit që ka të bëjë për kundërvajtjet në Republikën e Kosovës.

Me këtë ligj për gjykatat, që është miratuar kohë më parë në Kuvendin e Kosovës, është thënë që me hyrjen e tij në fuqi më 1 janar, nuk do të vlejë më tutje Ligji për kundërvajtjet. Duke marrë parasysh që më 1 janar do të jetë shumë shpejtë dhe që Kuvendi i Kosovës nuk do të ketë seanca tjera, unë ju lus për mirëkuptim, pas një konsultimi që kam pasur edhe me kryetarin e Komisionit për Legjislacion, që t'i japim mundësi që të vazhdojë Ligji për kundërvajtje edhe në vitin tjetër, derisa të miratohet ligji tjetër për kundërvajtje në mënyrë adekuate.

Këtë konsultim e kam bërë paraprak edhe me Këshillin Gjyqësor të Kosovës. E kundërta e saj është në të drejtën tuaj, deputetë të nderuar, të vendosni, por atëherë derisa të miratohet apo të shqyrtohet në muajin janar, derisa të hyjë në fuqi, pasi që ta nënshkruajë presidentja, të dalë në Gazetën Zyrtare, në muajin janar do të jemi të ngecur në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë për kundërvajtje.

Mendoj, që një veprim i tillë është ligjor dhe ju falënderoj paraprakisht.

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër Kuçi dhe ministër i Drejtësisë!

Sipas rregullit, fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka vlerësuar se ka bazë juridike dhe mund të procedohet. Mirëpo, këtu kemi edhe një propozim ose mocion, nëse mund ta kualifikoj të tillë, si të jashtëzakonshëm prej zëvendëskryeministrit, i cili propozon që ky ligj të kalojë në të dyja procedurat, sot. Do të thotë, në leximin e parë dhe në leximin e dytë, me sa kuptova unë, në mënyrë që të hyjë në fuqi më 1 janar. Nëse nuk ndodh kjo, atëherë mbetet që të kemi vakum ligjor, derisa të kalohet edhe në leximin e dytë.

Ju siç e dini, kjo në procedurë nuk mund të ndodhë, mirëpo duhet të marrë vendim seanca, që ta çojë me procedurë të jashtëzakonshme, nëse do të bëjë shkelje të procedurës me vendim të seancës, përndryshe, mendoj që është problematike. Këtu është vetëm një nen, i cili propozohet që të ndryshohet, mirëpo rregullat e Kuvendit janë që duhet të shkojë në dy lexime. Për të kaluar me një lexim, duhet të marrë vendim seanca për shkelje të Rregullores, ose anashkalim të Rregullores, nëse mund të përdor një gjuhë më të butë.

Parimisht, nuk ka kurrgjë kundër, konkretisht është një rregullim shumë i thjeshtë, i cili ndihmon sistemin e drejtësisë në Kosovë, mirëpo duhet të marrë vendim seanca gjithsesi. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë po ofroj mundësinë. Neni 84 lejon të ketë shmangie të tilla, veçse kjo shmangie votohet me 2/3-at e të pranishmëve në sallë, pastaj Komisioni e merr këtë punë në ndërkohë edhe vjen raporton. Kjo është rregulli, këtë e thotë Rregullorja.

Nëse ekziston, domethënë pëlqimi i 2/3-tave të Kuvendit, ne mund ta bëjmë këtë veprim. Unë dua të shoh sa jemi. Ma jepni listën, sa deputetë janë të pranishëm.

Kemi 56 deputetë. Ju lutem, votojmë për shmangie nga Rregullorja.

*(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)*

Në sallë janë 68 deputetë. Ju lutem, po votojmë për shmangie nga Rregullorja, në bazë të nenit 84, që ky ligj të aprovohet sot me një lexim, ose të kryhet sot, në mënyrë që të mund të hyjë në fuqi në fillim të vitit të ardhshëm.

Ju vendosni, nëse votojnë 2/3-at e të pranishmëve. Votojmë tash, ju lutem. Votoni me dorë, ose si të doni... votoni me elektronikë. Votojmë tash! Votoni me elektronikë!

Kemi për 55, një kundër dhe nuk ka abstenim. Ne votuam që ky ligj të kalojë me një lexim.

Atëherë kërkojmë që Komisioni, derisa të deklarohen grupet parlamentare, të mblidhet dhe ta japë opinionin e vet, para se ta votojmë totalisht ligjin. Faleminderit!

E ka fjalën Behar Selimi, për PDK-në.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Së pari i falënderoj deputetët për votimin që të shmangemi nga procedura dhe ta votojmë në një lexim, duke pasur parasysh rëndësinë që ka fakti që Ligji për kundërvajtje duhet të zbatohet edhe nga 1 janari.

Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK-së është që të aprovohet ligji në lexim të parë dhe të dytë, në të njëjtën kohë. Pra, ne e mbështetim që ky ligj të jetë i gatshëm për të hyrë në fuqi më 1 janar të vitit 2013. Faleminderit!

KRYESUESI: Për LDK-në, flet Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht që edhe ashtu gjendemi para një akti të kryer, sepse reforma në gjyqësor fillon në vitin 2013 dhe zbatimi i Ligjit për gjykatat. Edhe ashtu është i domosdoshëm miratimi i këtij ndryshimi. Si do që të jetë, ka qenë edhe në strategjinë legjislative për këtë vit Ligji për kundërvajtje, por tash Kuvendi vendosi dhe ne e kemi shprehur edhe përkrahjen tonë në Komision se duhet të kalojë në këtë formë, për shkak të kohës dhe rrethanave apo fillimit të reformave në sistemin e gjyqësorit.



Ne jemi për dhe do ta kryejmë punën edhe në mes këtyre dy leximeve që ky projektligj të kalojë sot.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Vetëvendosja”, deputetja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat dhe do të votojë në favor të këtij projektligji, pasi që nuk kemi ndonjë vërejtje përmbajtjesore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit shumë! Për AAK-në, Ardian Gjini, shef i Grupit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e voton këtë projektligj. Nuk shohim ndonjë problem të madh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit për deklaratën! Nga KKR-ja, Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah këtë projektligj dhe shpresojmë që në mënyrë të mirëfilltë sa më shpejt t’i fillojnë reformat në sistemin gjyqësor.

KRYESUESI: Faleminderit! Për SLS-në, deputetja Jasmina Zhivković e ka fjalën.

JASMINA ZHIVKOVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Imajući u vidu neophodnost što bolje organizacije sudstva, i Samostalna Liberalna Stranka će glasati i podržati ovaj predlog nacrta zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Nga grupi “6+”, Mufera Shinik e ka fjalën.

MÜFERRA ŞİNİK: Mahkemeler Yasasının, Kosova için ne denli değerli olduğunu hepimiz farkındayız. Aynı zamanda bugün de “6+” Parlamenter Grubu, bu yasayı oylayacaktır.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Pas deklarimeve të grupeve nuk kemi deputetë për të diskutuar. Unë tash e hedh në votim në leximin e parë. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 69 deputetë. Kanë votuar për 67 deputetë, një është kundër, asnjë abstenim. Ne e kaluam në lexim të parë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

E thërras Komisionin që ta bëjë raportin, për ta bërë votimin e dytë.

Në ndërkohë, derisa të na e bëjnë raportin, kalojmë në pikën e shtatë:

## **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbarimore**

*(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)*

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për procedurën përmbarimore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion, zotin Gashi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe i ka nxjerrë rekomandimet, të cilat i ka shndërruar në amendamente dhe kërkon nga seanca që këto amendamente të shqyrtohen një nga një, sepse kemi edhe amendamente të cilat janë propozuar nga deputetë individual, të cilët nuk e kanë marrë përkrahjen e Komisionit për Legjislacion.

Prandaj, si kryetar i Komisionit për Legjislacion, kërkoj që të shkohet me votim elektronik, një nga një të gjitha amendamentet. Janë gjithsej 13 amendamente. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Zonja Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, kryesues!

Atëherë, amendamentin të cilin e kam propozuar është që nenet nga 323 deri në nenin 398 të fshihen në tërësi nenet që kanë të bëjnë me përmbaruesin privat.

Unë nuk kam marrë ndonjë arsye përmbajtjesore në lidhje me kundërshtimin e amendamentit në Komision. Arsyeja ka qenë, që vetëm se e prishë strukturën e ligjit. Pra, ju e dini që përmbaruesi privat është risi në procedurën e ekzekutimit në Kosovë.

Fillimisht, konsideroj që është e panevojshme, që të kemi përmbarues privatë në këtë fazë të realitetit tonë. Sipas riformulimit të këtyre neneve vërehet një tendencë, kinse për t'i evituar problemet, mirëpo do të ketë shumë parregullsi, si në zgjedhjen ashtu edhe në veprimtarinë e tyre.

Së dyti, është gabim që ministri i Drejtësisë të caktojë përmbaruesin privat, sepse kjo mund të llogaritet si ndërhyrje në sistemin gjyqësor dhe atë në fazën finale, kur vendimet gjyqësore duhet të përmbarohen.

Kjo gjithashtu vlen edhe sa i përket caktimit të numrit të përmbaruesve privatë nga ministri i Drejtësisë.

Nëse e analizojmë me vëmendje këtë kapitull, vërejmë që të gjitha vendimet kryesore për përmbaruesit privatë, i merr Ministria e Drejtësisë duke përfshirë edhe emërimet, caktimin e numrit të përmbaruesve, ndërhyrjet te selia, të dhënat nga regjistri i përmbaruesve privatë, që shpallen në faqen e Ministrisë së Drejtësisë, organizimin e provimit, vulën e përmbaruesve privatë e tjera.

Së fundi, mendoj që është dashur të shtohet numri i përmbaruesve publikë, nëpër gjykata dhe të mbështeten në rastet kur ata kanë problem me përmbarimin e vendimeve gjyqësore, e jo të shtohen përmbaruesit privatë, si kategori e re në Kosovë.

Andaj, i ftoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që të votojnë për këtë amendament. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Gashi, kryetar i Komisionit, e ka kërkuar fjalën.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit!

Bëhet fjalë për 76 nene. Dhe mendoj që është një ndërhyrje shumë e fortë, nëse me një amendament i ndryshojmë 76 nene, në aspektin teknik.

Në aspektin përmbajtjesor dhe konceptual bëhet fjalë për një instrument të ri për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe një instrument, i cili llogaritet që mund të ndikojë pozitivisht në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Çështja është, koncepti i cili prezantohet, i cili është një koncept i politikave të djathta që ka për qëllim përfshirjen e sistemit privat në përmbarimin e vendimeve gjyqësore.

Ky është një koncept, i cili ka marrë përkrahjen në Komision, realisht. Zonja Haxhiu ka pasur propozimin e vet, që të hiqen këto 76 nene me një amendament. Nëse seanca e vlerëson që duhet të hiqen këto 76 nene, duhet të ketë parasysht, unë mendoj se nëse këto

76 nene hiqen, duhet t'i kthehet komplet ligji në Qeveri, sepse ndryshon komplet koncepti i ligjit.

Me një amendament të heqim 76 nene, është goxha ndryshim përmbajtjesor. Dhe, vetëm si paralajmërim për seancën, që ta ketë parasysh se çka po votohet. Është një koncept, i cili përdoret në vende të ndryshme. Sot vendoset a do të kemi në Kosovë apo nuk do të kemi përmbarues privatë, të cilët merren me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në kontestet civile. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Haxhiu kërkon replikë.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, kryesues! Po, është konceptuale, mirëpo nuk ke nevojë Arben, për t' i thyer konceptet. Dëmet, që do t'i sjellin Kosovës këto nene, apo përmbaruesi privat, janë shumë të mëdha. Po, qytetarëve të Kosovës, pra do t'u sjellin dëme të mëdha, kështu që deputetët duhet të mendojnë drejt dhe mirë, ndërsa sa i përket aspekteve teknike, për to nuk duhet as që të flasim, për shkak se ne po qëndrojmë, jemi përballë një problemi shumë të madh, që po iu kanoset qytetarëve dhe Kosovës, andaj po, është shumë më mirë, që të kthehet ligji. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kundërreplikë, zoti Gashi!

**ARBEN GASHI:** Jo, veç sa për sqarim për zonjën Haxhiu. Unë si kryetar i Komisionit e kam për detyrë t'i paralajmëroj deputetët me pasojat e vendimit, i cili mund të merret. Unë nuk po them që deputetët janë të painformuar ose nuk e dinë, mirëpo unë dua t'i paralajmëroj se nëse kalon propozim-amendamenti i zonjës Haxhiu, atëherë kemi parasysh që hiqen 76 nene dhe po ashtu, si grup parlamentar, mendojmë se duhet të ekzistojë sistemi i përmbaruesit privat, sepse është një koncept i politikave të djathta, të cilin ne e përkrahim si grup parlamentar, mirëpo, për këtë çështje merr vendim seanca. Tash e kemi çështje në vendimmarrje të seancës dhe deputetët vendosin, pavarësisht diskutimeve të mija dhe të Albulenës, nuk është çështje e debateve personale, është çështje e diskutimeve konceptuale, për të cilat, normalisht mund të mos kemi përputhje në mendime. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, zoti Kuçi e ka fjalën.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI:** Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit zoti Gashi për sqarimet që i dhatë në emër të Komisionit.

Natyrisht, që unë e kam marrë edhe herën e parë nga deputetja Haxhiu vërejtjen e tillë. Atë që e tha për dallime konceptuale, e kam thënë edhe herën e parë dhe besoj, që është e drejtë e secilit ta mbrojë konceptin e vet.

Po, më lejoni t'i jap dy-tri arsyetime pse duhet të mbetet kjo.

Në politikat e mia si ministër i Drejtësisë, kam tentuar që të zvogëloj numrin e lëndëve në gjykata, ngase ajo është pjesa kryesore, që e rëndon sistemin tonë të drejtësisë dhe është pjesa kryesore, që qytetarët tanë nuk i besojnë shumë drejtësisë, kur një lëndë e tyre pret për vite të tëra.

Po ashtu, më lejoni të them, që ne kemi themeluar sistemin e noterisë në Kosovë, që ka zvogëluar dukshëm numrin e lëndëve në gjykata, sistemin e ndërmjetësimit, sistemin e arbitrazhit. Përmbauesit privatë, vetëm një fakt do të jua jap: në gjykatat tona mbeten si lëndë të pakryera mbi dyqind e 125 mijë lëndë dhe prej tyre mbi 100 mijë kanë të bëjnë me përmbarimin. Do të thotë, gjysma e lëndëve të gjykatave sot kanë të bëjnë me këtë segment. Kemi pasur përmbaues publikë, që tha zonja Haxhiu, dhe unë nuk besoj që s'kanë mund dhe nuk mund ta kryejnë punën as në të ardhmen.

Sa për praktikat tjera, dua t'i them dy praktika. E para, në shtetet fqinje, cilindo që e merrni: Shqipërinë, Maqedoninë dhe Slloveninë, dhe në të gjitha vendet e BE-së, kushdo që ka qenë e ka parë që ka logjikë të përmbauesve privatë.

Ata nuk e dëmtojnë sistemin, ata kanë rregulla, kanë sistem, kanë organizim, kanë përgjegjësi para ligjit dhe përzgjedhja e tyre do të bëhet nga një bord i veçantë, jo nga ministri. Disiplinimi bëhet nga ministri dhe unë besoj që kjo është e drejtë, po nuk është me rëndësi kush është ministër.

Unë po them që ky sistem do të vazhdojë në vitin 2014, kurse në vitin 2013 s'do të jetë fare.

Dhe e fundit, çka dua të them, ky ligj nuk ka kuptim pa përmbaues privatë. Atëherë, nëse dëshironi e lëmë kështu, por unë besoj që përmbauesit privatë që do të fillojnë në vitin 2014, do ta lehtësojnë shumë sistemin e drejtësisë.

Dhe, krejt në fund, po e them, hartimin, por edhe projektin e USAID-it e kam që nga maji të fillojë në përgatitjen e tyre që ata e kanë përgatitur dhe do t'i përgatisin përmbauesit në Kosovë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Haxhiu!

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, kryesues!

Atëherë, kur mungon shteti i së drejtës, është shumë e rrezikshme që të kemi përmbaues privatë.

Shembullin e Shqipërisë mund ta marrim edhe ne. Pra, e dimë se si funksionon përmbauesi privat në Shqipëri, kështu që vuajtjet e qytetarëve nga përmbauesi privatë do ta hapin sigurisht këtë temë përsëri.

Mirëpo, unë e kam një pyetje për ministrin e Drejtësisë. Pse nuk e shtoi numrin e përmbauesve publikë nëpër gjykata, por është dashur të kemi përmbaues privatë?

**KRYESUESI:** Zoti Kuçi e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Unë besoj se është çështje e debatit pak më të gjerë dhe për ata që janë juristë, dhe Albulena unë sa e di, ju jeni juriste, nuk është fjala vetëm me Shqipërinë e me Maqedoninë. Pra, është fjala edhe me Gjermaninë, nëse e keni dikë atje, zoti Hoti mund t'ju tregojë, përmbaruesit privatë e ndihmojnë funksionimin e shtetit të së drejtës, jo që e pengojnë. Dhe, nëse keni durim, unë do t'ju dëgjoj.

Dhe, ajo çka dua të them është që çështja e përmbaruesve publikë, nëse veç ju po e thuani, përmbaruesit publikë i kushtojnë buxhetit të shtetit. Përmbaruesit privatë i japin apo i sjellin buxhetit të shtetit, dhe po ashtu dua të them, qytetarët s'do ta kenë asnjë telashe. Do të kenë telashe ata që s'janë duke i kryer vendimet e gjykatave, të tjerët s'do të kenë telashe me ta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E hedh në votim amendamentin 6 dhe e përsëris propozimin e deputetes Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tash.

Nuk kalon amendamenti 6. Janë 46 vota kundër, 11 për dhe asnjë abstenim.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Tani, të nderuar kolegë dhe kolege, e votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Në sallë janë 68 deputetë. Votojmë tash.

Konstatohet që me 50 vota për, 9 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për procedurën përmbarimore.

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

## **6. Shqyrtimi i raportit të punës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011**

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar raportin e punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar që ta shqyrtojë në mbledhjen plenare.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion, zotin Gashi për arsyetimin e raportit me rekomandime.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Këshilli Gjyqësor i Kosovës e ka sjellë raportin e punës për vitin 2011 dhe Komisioni e ka shqyrtuar.

Paraprakisht, më lejoni t'ju informoj për disa çështje procedurale dhe teknike. Ju normalisht mund të pyesni se çka kemi të bëjmë ne tash në fund të vitit 2012, me raportin e punës për vitin 2011? Keni të drejtë. Është një shqetësim i drejtë, mirëpo duhet t'i kemi parasysh disa elemente.

Është hera e parë që Këshilli Gjyqësor i Kosovës raporton në Kuvend. Ju e dini se Këshilli Gjyqësor, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të paktën një herë në vit, i drejtohet Kuvendit lidhur me punën dhe aktivitetin e tij.

Sa i përket kësaj çështjeje ka pasur një debat dhe diskutim, fillimisht kryetari i Këshillit Gjyqësor ka shprehur interesin e tij që të flasë direkt në seancë, kërkesë, e cila i është drejtuar Komisionit dhe ai pastaj e ka drejtuar në Kryesinë e Kuvendit.

Kryesia e Kuvendit, ka vendosur që të kemi paraprakisht respektim të procedurave dhe të mënyrës së punës siç veprohet me agjencitë tjera të pavarura dhe është kërkuar nga Këshilli Gjyqësor, që të raportojë në Komision dhe pas raportimit në Komision, seanca të vendosë nëse është me rëndësi që kryetari i Këshillit Gjyqësor të raportojë edhe në seancë.

Si rezultat i kësaj, kryetari i Këshillit Gjyqësor është ftuar në Komision dhe ka raportuar për aktivitetin dhe mosaktivitetin e Këshillit Gjyqësor.

Sa i përket raportit, Komisioni ka vërejtur shumë probleme dhe defekte, të cilat i janë paraqitur edhe kryetarit të Këshillit Gjyqësor dhe është kërkuar nga ai që të bëjë përmirësime dhe duke marrë parasysh se është hera e parë që raportohet në Kuvend, janë dhënë edhe udhëzime të nevojshme të cilat duhet të merren në konsideratë.

Problemet që janë vërejtur kanë të bëjnë më shumë jo me raportin, tash në qoftë se flasim për përmbajtje, por janë probleme me Këshillin Gjyqësor të cilat dalin nga vetë përbërja e Këshillit Gjyqësor, emërimi dhe riemërimi i gjyqtarëve nëpër gjykata, emërimi apo riemërimi i kryetarëve të gjykatave dhe shumë probleme tjera që janë probleme reale me të cilat përballet sot sistemi i drejtësisë në Kosovë.

Një problem shqetësues, i cili është ngritur po ashtu në Komision nga deputetët anëtarë të Komisionit është numri i madh i lëndëve, të cilat ka vite të tëra që nuk kanë marrë zgjidhje në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Dhe, kryetari i Këshillit Gjyqësor, po ashtu ka ndarë mendimin me anëtarët e Komisionit se të gjitha shqetësimet që janë vërejtur këtu janë shqetësime të bazuara dhe mendon se duhet të ketë punë më të madhe që të rritet kualiteti i punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Emërimi dhe riemërimi i gjyqtarëve është një problem shumë i madh dhe sidomos zgjedhja e kryetarëve të gjykatave. Në zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave ka ndodhur që të kemi shumë të rënda ligjore dhe kushtetuese nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, sidomos me emërimet e kryetarëve të gjykatave, ku ka ndodhur që është emëruar apo zgjedhur kryetari i Gjykatës Themelore, kandidati i cili nuk e ka përfunduar afatin e paraparë ligjor si punë provuese. Domethënë, është zgjedhur kryetar gjykate dikush që është në provë, që është shkelje e rëndë gjyqësore dhe kushtetuese dhe mendojmë se është po ashtu është ndërhyrje edhe politike apo afilacion politik apo familjar në zgjedhjen e këtyre kryetarëve të gjykatave, apo anëtarëve të gjykatave. Pra, është në problem shumë i rëndë.

Një problem tjetër i cili është vërejtur dhe është diskutuar gjatë në Komision, po ashtu me kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është problemi i shqiptimit të masave të arrestit për të gjitha rastet që procedohen nëpër gjykata. Dhe, ky është një problem që ka të bëjë me konceptin e drejtësisë dhe është një problem i cili në krahasim me vendet në rajon apo me vendet e Bashkimit Evropian, është jashtëzakonisht shumë i lartë. Në Kosovë, sipas raporteve që na kanë ardhur, mbi 90% e kërkesave për shqiptim të masës së arrestit me burg në fazën paraprake aprovohen në procedurë gjyqësore. Në vendet e Bashkimit Evropian, norma është më e ulët se 50% dhe po ashtu në vende të rajonit.

Kjo nga aspekti i trajtimit të Komisionit është vlerësuar që mund të jetë në kundërshtim me liritë dhe të drejtat e njeriut, ndërkohë që në të njëjtën kohë ka njerëz që janë me dënim të formës së prerë dhe rrinë në liri, sepse kanë afilacion politik ose përkrahje politike dhe është shkelje shumë e rëndë e sistemit të drejtësisë. Kjo është një procedurë shumë e rëndë dhe është shndërruar realisht në një instrument politik për dënim dhe gjykim publik, sepse kemi pasur plot raste kur njerëzit janë arrestuar nga policia apo prokuroria, është shpallur masa e arrestit me burg nga gjykata dhe mbas një kohe afati, kur janë mbyllur afatet gjyqësore pala është shpallur e pafajshme dhe tashmë dënimi publik i është dhënë dhe cili është kompensimi moral që mund t'i bëhet?

Prandaj, është kërkuar gjithashtu nga Këshilli Gjyqësor që të ndërtohen procedura në kuadër të pavarësisë kushtetuese e ligjore të Këshillit Gjyqësor që të jetë synim kryesor



mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të interesave të individit në procedurë gjyqësore, sepse është vërejtur si shumë shqetësues shqiptimi i masës së arrestit me burg dhe gjykim kolektiv publik për njerëzit për të cilët është ngritur një akuzë, e cila realisht mund të jetë edhe e pabazë. Dhe, shpesh ka ndodhur që akuza e ngritur është vërtetuar se është e pa bazë nga vetë sistemi gjyqësor dhe çka është bërë me ata gjyqtarë të cilët si rezultat i ndërhyrjes politike apo ndërhyrje tjetër nga jashtë, ka shqiptuar masa të arrestit me burg?

Prandaj, mendoj se këto janë problemet kryesore që janë vërejtur. Problemi është emërimi dhe riemërimi i gjyqtarëve, përbërja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, emërimi apo zgjedhja e kryetarëve të gjykatave, shqiptimi i masave të sigurisë për persona në procedurë penale dhe disa elemente tjera që kanë të bëjnë po ashtu edhe elementi kryesor që ka të bëjë me lëndë të shumta që presin nëpër gjykata. Janë domethënë pesë shtylla kryesore problematike në sistemin e drejtësisë të cilat janë diskutuar në detaje me kryetarin e Këshillit Gjyqësor dhe nga i cili është kërkuar që në raportin e ardhshëm të ketë progres, përndryshe duhet të trajtohet më me kujdes dhe më me seriozitet.

Ne e dimë që Këshilli Gjyqësor është institucion i pavarur kushtetues dhe e ka pavarësinë e vet funksionale kushtetuese, mirëpo edhe përgjegjësinë e vet për mosfunksionimin e sistemit të drejtësisë duhet ta ketë. Dhe, në këtë kuptim mendoj se si Kuvend duhet ta kalojmë formalisht këtë raport, sepse është hera e parë që raporton dhe kryetari i Këshillit Gjyqësor e ka pranuar edhe vetë që mund të ketë edhe probleme, ta kalojmë formalisht, mirëpo me vërejtjet të cilat janë dhënë edhe në Komision dhe po riartikulohej sot në seancë.

Edhe një çështje e fundit, në fund të raportimit të kryetarit të Këshillit Gjyqësor, nga kryetari i Komisionit dhe anëtarët e Komisionit, i është shtruar pyetja se a qëndron ende vullneti i kryetarit të Këshillit Gjyqësor që të raportojë para seancës? Ai tha se e konsideron se është ezauruar debati dhe vërejtjet janë marrë në konsideratë dhe nuk vlerëson të arsyeshme ose të nevojshme, përveç nëse seanca kërkon që të raportojë në seancë.

Prandaj, si Komision kërkoj nga deputetët që formalisht ta kalojmë raportin, mirëpo vërejtjet të potencohen dhe kryetari i Këshillit Gjyqësor dhe Këshilli Gjyqësor në përgjithësi të merret me sanimin e defekteve deri në raportin tjetër, i cili duhet të vijë brenda afateve ligjore dhe të mos ndodh më që në fund të vitit tjetër kalendarik të na vijë raporti për një vit paraprak. Prandaj, ky është konkluzioni i Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Gashi. Radha është e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Kryetarja, nuk është këtu. S'ka autorizuar askënd. Vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Krasniqi është paraqitur.

**HALIT KRASNIQI:** Faleminderit, kryesues!

Edhe në Grupin Parlamentar të PDK-së e kemi shqyrtuar raportin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe i kemi dhënë mendimet tona. Gjithashtu përfaqësuesit tanë në Komision të

Legjislacionit kanë dhënë kontributin e tyre dhe kanë debatuar me kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. I kanë ngritur të gjitha shqetësimet e Grupit Parlamentar dhe i kanë trajtuar dukuritë të cilat janë manifestuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Natyrisht, aty i kemi dhënë propozimet konkrete dhe idetë tona i kemi përshkruar gjerësisht. Këtu nuk do të lëshohem në asnjërën prej tyre, por do të deklarojmë se jemi për ta kaluar raportin me votën tonë këtu në procesin e votimit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i LDK-së, zoti Gashi është paraqitur.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit!

Veç sa për procedurë, unë po rikonfirmoj se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. mbështet vendimin e Komisionit dhe kërkon që formalisht të kalohet raporti dhe vërejtjet që janë konstatuar në mbledhje të Komisionit të merren seriozisht nga Këshilli Gjyqësor dhe të trajtohen si vërejtje substanciale në këto pesë fusha të cilat janë identifikuar. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga “Vetëvendosje” e ka fjalën zonja Haxhiu.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, kryesues!

Në aspektin përmbajtësor konsideroj se raporti vjetor i KGJK-së, për vitin 2011 përmban frazeologji të tepërta, të cilat e përshkruajnë funksionimin e disa organeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Në këtë raport janë të shkruara gjithashtu edhe disa fraza standarde të cilat aspak nuk përkohet me gjendjen reale të sistemit të drejtësisë. Pra, flitet për një gjyqësor të pavarur transparent, kur dihet se tashmë nuk kemi një gjyqësor të pavarur dhe kjo gjendje për çdo ditë po përkeqësohet, e gjithashtu që është Këshilli Gjyqësor ai i cili nuk është aspak transparent në raport me qytetarët, mediat apo shoqërinë civile. Pra, për çdo ditë ballafaqohen me përgjigje negative nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mirëpo edhe me mospërgjigje.

Në faqen 6 të Raportit mbi komisionet e KGJK-së, ndër të tjera janë përfshirë komisionet e përhershme të KGJK-së, në tekstin e mëtejshëm nuk bëhet fjalë për Komisionin për Çështje Normative. Pra, nuk është dhënë asnjë detaj mbi funksionimin dhe veprimtarinë e këtij komisioni.

Në faqen 7 të raportit është referuar në funksionimin dhe aktivitetin e Komisionit Disiplinor. Këtu është cekur se Komisioni Disiplinor ka mbajtur gjithsej 12 seanca disiplinore, në të cilat janë shqyrtuar 63 raporte të Zyrës së Prokurorit Disiplinor. Sipas kësaj dinamike del se Komisioni Disiplinor për çdo seancë ka shqyrtuar më pak se 5.5 raporte për çdo seancë të mbajtur. Kjo tregon se është i pamundur një shqyrtim objektiv dhe i drejtë i këtyre raporteve në drejtim me vendimet që janë marrë.

Në anën tjetër, po në këtë faqe, specifikohet se për këto 12 seanca janë marrë gjithsej 57 vendime lidhur me këto raporte.

Në përshkrimin e llojit të marrjes së vendimeve nuk shihet se është shqiptuar masa më e rëndë disiplinore konform nenit 37 nën-paragrafi 1.4, pra propozimi për largimin nga zyra të gjyqtarit apo gjyqtarit porot. Pra, kjo na shpie tek pyetja se a e ka kryer punën ZDP-ja, kur kihet parasysh se të gjitha këto raporte mbi shkeljet disiplinore nga gjyqtarët.

Pra, dënimet e Komisionit Disiplinor janë qesharake. Këtu vlen të përmendim edhe rastin e të ndjerës Diana Kastrati, e cila kishte kërkuar mbrojtje emergjente nga Gjykata Komunale, por që fatkeqësisht nuk iu dha, dhe masën disiplinore që e ka marrë Komisioni Disiplinor, ndaj gjyqtarit, është ndërprerja e pagesës përgjysmë për tre muaj. Pra, kjo është fyerje edhe për familjarët e Dianës, mirëpo edhe për shtetin e së drejtës dhe sistemin e drejtësisë në vend.

Në faqen 9 specifikohet se sa i përket stafit mbështetës Komisioni Disiplinor ka qenë shumë më i rreptë dhe më rigoroz sa i përket shqiptimit të masave disiplinore, ku nga 11 raste, për tri raste është shqiptuar masa për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Ky fakt është tejet shqetësues ngase na shpie deri te konstatimi se ky rigorozitet ka për qëllim disiplinimin, ndoshta edhe në aspektin politik të stafit mbështetës.

Edhe pse është një nga njësitë organizative më të rëndësishme në faqen 13 ku elaborohet mbi funksionimin e Njesisë për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore, teksti i parafrazuar është tejet i varfër. Kjo pjesë e raportit më shumë trajton aspekte teorike mbi kompetencat dhe autorizimet e kësaj njësie se sa do të duhej të pasqyronte aktivitetin e saj për periudhën njëvjeçare.

Tek pjesa e raportit ku flitet për emërimin e gjyqtarëve shihet një diskrepancë lidhur me kërkesat reale të gjykatave dhe plotësisht të vendeve të lira të punës dhe procesit të emërimit të gjyqtarëve. Këtu vlen të përmendim emërimet e fundit të gjyqtarëve, të cilat kanë qenë përplot me shkelje, mirëpo edhe puro-politike.

Në faqen 16 të raportit është cekur ecuria e zbatimit të strategjisë shtetërore për reduktimin e lëndëve të vjetra, ku theksohet se zbatimi i saj ka filluar nga 1 janar 2011 dhe do të duhej të përfundojë më 31 dhjetor 2012.

Pra, nuk është ndonjë strategji efektive dhe që do t'i reduktojë lëndët e vjetra. Për më tepër nga bilanci i evidentuar për vitin 2011, del se nga gjithsej 99 mijë e 798 lëndë janë zgjidhur brenda vitit janë 2011, 54 mijë e 973 lëndë, për të mbetur për vitin e ardhshëm 44 mijë e 825 lëndë, që i bie se për çdo gjyqtar do të ketë në dispozicion 150 lëndë për një vit. Kjo i bie se çdo gjyqtar do të duhej të zgjidhë për çdo ditë pune nga një lëndë. Kjo normë e lartë rrezikon kualitetin e mbrojtjes gjyqësore gjatë zgjidhjes së lëndëve të parashtruara në gjykatat e Kosovës.

Çështje tjetër brengosëse është se në aspektin e përfaqësimit gjinor, KGJK-ja ka dështuar që të përmirësojë pasqyrën gjinore në sistemin gjyqësor. Kjo është cekur në faqen 24 sipas të dhënave të raportit. Pra, pjesëmarrja e gjinisë mashkullore është 72,6% , ndërsa ajo e femrave 27,94%.

Pra, për këto arsye ne nuk mund të votojmë në favor të këtij raporti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, fjalën e ka zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Duke kërkuar që të vihet theksi dhe të nënvizohen të gjitha ato që i përmendi si lëshime kryetari i Komisionit për Legjislacion, zoti Gashi dhe po ashtu shumë prej atyre që i tha zonja Haxhiu, mendojmë se kësaj radhe ky raport duhet të kalojë. Sidoqoftë, prapë po them, qëndron theksi në elementin se Kuvendi duhet të fillojë që në të ardhmen t'i shikojë me kujdes të gjitha elementet të cilat u përmendën këtu si lëshime në sistemin tonë të drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kelmendi, në emër të Koalicionit Kosova e Re.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe pse raporti në fjalë paraqet raportin e vitit 2011, do të thotë ne jemi në fund të vitit 2012, dhe megjithatë është bërë një hap i mirë në drejtim të raportimit në Kuvendin e Kosovës sa i përket gjendjes në sistemin e gjyqësorit në Kosovë.

Padyshim, të gjithë e dimë që sistemi i gjyqësorit në Kosovë është në gjendje të rëndë, nuk është i pavarur. Është i ndikuar nga shumë faktorë, nga politika, është i ndikuar edhe nga korrupsioni, vërejtje këto të cilat kanë qenë edhe në Raportin e Progresit të vitit të kaluar, andaj shpresojmë se do të bëhet një hap më tutje e sidomos nga viti 2013, kur do të fillojmë me reformat në sistemin gjyqësor, ku do të kemi një reformim të mirëfilltë të këtij sistemi dhe më në fund luftim të korrupsionit në vetë këtë institucion.

Vlen të përmendet gjithashtu edhe shkeljet që janë bërë, qoftë në emërimin e poste të larta në sistemin e gjyqësorit, por edhe në Këshillin Prokurorial. Fjalën e kam për konkursin të fundit që është mbajtur në tërë Kosovën e veçanërisht në Pejë, ku kemi klasifikim dhe zgjedhje të kandidatëve të pakualifikuar, kemi ndërhyrje edhe të nepotizmit në gjitha sferat e gjyqësorit.

Në këtë rast po flas për konkursin e fundit të Këshillit Prokurorial, të mbajtur së fundmi dhe unë propozoj që ky gjyqësor i Kosovës njëherë e përgjithmonë të fillojë me reforma dhe përzgjedhja (selektimi) i kandidateve të mos bëhet nga një komision i ngushtë tre anëtarësh, por të jetë komision më i gjerë, më gjithëpërfshirës dhe transparent. Tek e fundit, të përfshihet edhe publiku në atë komision për selektimin e prokurorëve dhe gjyqësorit.

Fatkeqësisht, më duhet të them se është krijuar një mentalitet në mendjen tonë, në vendin tonë se sot nuk shquhet avokat i mirëfilltë ai i cili ka vlera të mirëfillta intelektuale e profesionale, por shquhet avokat i mirëfilltë ai i cili ka lidhje me gjyqësorin, i cili korrespondon mirë me lidhjen me prokurorin dhe gjykatësin, është bërë një zinxhir i

korrupsionit në mes avokatit, prokurorit dhe gjykatësit, kur më së paku e pëson ekzekutuesi apo i pandehuri, ndërsa ndëshkohet viktimja.

Prandaj, ky raport, edhe pse ka mangësitë e veta të përmendura, mendoj që duhet të kalojë për faktin se është një hap përpara drejt reformimit të këtij sistemi e veçanërisht kur në vitin 2013 priten reforma të mirëfillta.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga SLS, zonja Zhivković e ka fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem, predsedavajući!

Samostalna liberalna stranka takođe razmatrala Izveštaj Sudskog saveta Kosova, prihvaćiće ovaj izveštaj uz jednu veliku napomenu i samim tim preporuku Sudskom savetu Kosova.

Naime, iz samog Izveštaja Sudskog saveta Kosova se jasno vidi da je nedovoljno zastupljenost sudije i javnih tužioaca iz redova manjinskih zajednica i apsolutno je neophodno popunjavanje svih tih mesta i pozicija za manjinske zajednice da bi sam Sudski savet i organizacije i sastav suda funkcionisalo kako treba u društvu Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Kervan, nga “6+”

ENIS KERVAN: Faleminderit, nënkryetar!

Ne mendojmë që ky raport duhet të kalojë dhe e përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar, që nuk jeni këtu,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Më duket pak e pazakonshme që raporti për punën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë vitit 2011, të shqyrtohet në fund vitit 2012.

Me këtë distancë kohore, vërejtjet dhe sugjerimet që mund të dalin sot, nuk besoj se mund të ketë ndonjë efekt të madh. E para, për faktin se gjendja aktuale, ajo në dhjetor të vitit 2012, mund të ketë ndryshuar, qoftë për të mirë apo për të keq, krahasuar me dhjetorin e vitit 2011, për të cilin ka qenë edhe ky raport.

Por, pa marrë parasysh këtë unë po potencoj disa probleme të cilat besoj se edhe tash janë aktuale.

Pa marrë parasysh këtë raport që mundohet të japë një pasqyrë të mirë, megjithatë sistemi i drejtësisë është kulmi i të gjitha problemeve që ka vendi ynë. Në vend se aty problemet të zgjidhen, ato lihen në pritje apo ndoshta edhe ngatërrohen dhe për këtë ka plot fakte.

Nën 1, në raport thuhet se është miratuar strategjia shtetërore për reduktimin e lëndëve të vjetra. Përmendën edhe disa të arritura lidhur me zbatimin e tyre, që janë minore në krahasim me problemet e rënda që janë të pranishme në këtë sektor.

Në të vërtetë, të gjitha demantohen kur merret parasysh numri i lëndëve të papërfunduara, të cilat ndoshta presin shumë e shumë vjet. Sipas raportit, gjatë vitit 2011 kanë mbetur të pazgjidhura 213 mijë e 37 lëndë.

Se numri i këtyre lëndëve ka qenë në rritje, tregon edhe fakti se gjatë këtij viti janë pranuar 86 mijë e 394 lëndë të reja, ndërsa janë zgjidhur 82 mijë e 895 lëndë. Sipas kësaj në vitin 2011 kanë hyrë në procesin e zgjidhjes edhe 3 mijë e 589 lëndë të reja. Kjo tregon për efikasitetin e ulët.

Sado që në raport nuk thuhet, nga shifra del e qartë se me këtë dinamikë të punës shumë qytetarë të Kosovës apo edhe subjekte ekonomike për një kohë të gjatë do të presin fjalën e drejtësisë, meqenëse këtu ka ngecje të mëdha, ndërkaq secila ngecje në sektor devalvon të gjitha të arriturat në sektorë tjerë.

Për më keq, ndoshta pikërisht për shkak të neglizhencës në sistemin e drejtësisë lindin ngatërresa, kurse subjektet ekonomike sillen buzë falimentimit.

Këtë situatë po e ilustrim me problemet më të cilat po përballen sektorët bankar. Sipas disa informatave, me vite të tëra presin mbi 8 000 lëndë në gjykatat tona dhe që ndërliken me kontekstet në këtë sektor.

Për shkak të pritjeve të gjata dhe numrit të lëndëve që është në rritje, është vendosur që përparësi të kenë lëndët që datojnë para vitit 2008. Do të thotë se as që merren në shqyrtim lëndët që janë më të vjetra se katër vjet.

Merreni me mend se me çfarë kamatash dhe shpenzimesh të panevojshme ngarkohen individët apo subjektet ekonomike për shkak të mungesës së azhuritit të gjykatave.

Kjo situatë ngarkon si kredimarrësit, ashtu edhe kredidhënësit, meqenëse institucionet financiare janë të interesuara që sa më parë të tejkalohen problemet e jo që ato të zvarriten. Kjo mungesë e azhuritit është njëri prej faktorëve kryesor pse kemi norma kaq të larta të interesit dhe kamata të cilat i zbatojnë institucionet financiare apo bankat në Kosovë.

Duke pasur parasysh joefikasitetin e sistemit të gjyqësisë, bankat këtë e kalkulojnë si risk, e ky rrezik është i madh prandaj edhe ndikon që kostoja e shërbimeve bankare të jetë edhe e lartë.

Problemi ka zgjidhje, por duket se për këtë nuk ka vullnet. Po e përmend rastin e Maqedonisë, e cila brenda sistemit të vet gjyqësor ka krijuar ekip të specializuar për zgjidhjen e kontestit të pranishëm në tregun financiar të tyre. Kjo mënyrë e punës, jo vetëm se rrit efikasitetin e gjykatave, por në të njëjtën kohë ndikon pozitivisht si te bankat

ashtu edhe te kredimarrësit. Kjo, padyshim se është edhe një arsye më shumë se Maqedonia qëndron shumë më mirë se Kosova, sa i përket ambientit për biznes, prandaj për ta përmirësuar këtë ambient nuk na duhet vetëm miratimi i ligjeve, por zbatimi i tyre, e kjo nuk mund të bëhet pa gjyqësi efikase.

Në raport, kalimthi përmendet puna e Dhomës së Posaçme në Gjykatën Supreme, apo Gjykatës së Specializuar për Privatizim, mirëpo nuk kemi asnjë të dhënë për punën që e bën ajo. Ndërkaq, dihet se këtu qëndrojnë të gjitha problemet që ndërlidhen me procesin e privatizimit, sikur është fjala për kontestet pronësore, ato për kompensimin e punëtorëve apo edhe për përfundimin e procesit të likuidimit të ndërmarrjeve të vjetra.

Pra, për shkak të mosefikasitetit të Gjykatës së specializuar për privatizim, tash e sa vite mbesin të bllokuar mbi 500 milionë euro, ndërkaq në momentin e rëndë nëpër të cilin po kalon popullata dhe ekonomia e vendit tonë, deblokimi i tyre do të ishte një ndihmë shumë e madhe, por kjo nuk mund të ndodhë vetëm për shkak të Dhomës së Veçantë në Gjykatën Supreme.

Unë do të kisha pasur dëshirë që në Raportin për vitin 2012 ky këshill të na sjellë më shumë informacione për punën e kësaj dhome. Prandaj, me gjithë këto vërejtje të cilat janë në këtë raport, unë prapëseprapë propozoj që ky raport të kalojë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Nuk po i përsëris ato që i thanë kolegët e mi se a është raporti i vonuar apo jo, ne këtë vlerësim e kemi dhënë, pasi që jam edhe anëtar i Komisionit Funkcional, por më lejoni t'i theksoj dy çështje që unë mendoj se kanë ngecur apo t'i vlerësoj edhe arritjet e Këshillit Gjyqësor në përgjithësi dhe të sistemit të drejtësisë në vend.

Përparimi në fushën e drejtësisë vazhdon të hasë në vështirësi dhe të pengohet nga ndërhyrjet politike në forma të ndryshme duke përdorur shpeshherë edhe mediat e kontrolluara për të krijuar një mosbesueshmëri në punën dhe vendimet e pavarura të gjyqësorit në përgjithësi.

Gjyqtarët dhe prokuroritë shpeshherë janë edhe të kërcënuar, të frikësuar dhe nuk shohin siguri në mbrojtje nga institucionet tjera përgjegjëse, gjë e cila minimizon punën dhe efikasitetin në zbatimin të ligjit si dhe luftën kundër krimit të organizuar, por edhe të korrupsionit.

Kjo reformë e proklamuar duhet të jetë në bazë të meritës së përzgjedhjes së gjyqtarëve e prokurorëve e jo në bazë të interesave të njërit apo tjetrit individ.

Fokusi në fillimin e reformës së gjyqësisë për vitin 2013, ku qytetarët presin një efikasitet të pavarur dhe paanshmëri për të përmirësuar sundimin e rendit dhe të ligjit, po përcillet

me një sistem të drejtësisë, i cili jo vetëm se po konsiderohet jo i pavarur, jo efektiv dhe i pa përgjegjshëm, është e sigurtë që liritë dhe të drejtat e qytetarëve si dhe interesat tona do të jenë të minimizuara dhe jo të garantuara ashtu siç e garanton ligji dhe Kushtetuta.

Nga të gjitha mënyrat e informimit, rezulton se krimi dhe korrupsioni nuk kanë një trend të zbritjes, por është edhe më i përshkallëzuar se sa në vitet paraprake.

Ne kemi kërkuar që në raportin e Këshillit Gjyqësor të jetë kjo performancë, ky angazhim dhe të kemi rezultate konkrete në fushën e gjyqësisë.

Një çështje shqetësuese është edhe komunikimi prokurori dhe gjykata, ku konkretisht, jo rrallëherë kemi rrjedhje të informacioneve, dokumenteve në hetim, procesverbale, dëgjime dhe kjo është shqetësuese si fenomen dhe si pengesë në luftën dhe parandalimin e veprave penale.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në vitin 2010 kishim vjedhje të organizuara të votave të cilat cenuan demokracinë dhe prodhuan institucione të brishta. Kjo nuk është paraqitur fare në këtë raport. Nga ngritja e aktakuzave dhe vendimeve të gjykatave, kishte ndëshkime simbolike dhe pa gjetur organizatorët e motivuesit e këtij krimi ndaj votës së lirë. Kjo tregon se sa është i ndikuar gjyqësori nga politika apo edhe të ashtuquajturit të fortit të lidhur me politikën.

Dhe, për fund, qytetarët e vendit kanë të drejtë të kërkojnë një sistem të drejtësisë, të standardeve evropiane të pavarur nga pushtetet tjera. Sot në tavolinat e prokurorisë dhe gjyqësisë, rrinë dosjet e vrasjeve për motive politike. Shtrohet pyetja, pse nuk arrestohen kriminelët të cilët përgjakën Kosovën dhe sigurisht për të mbuluar krimet e tyre janë të gatshëm të bëjnë edhe krime tjera, vetëm e vetëm për të ruajtur pushtetin politik, ekonomik dhe kriminal.

Këto janë vërejtjet tona që duhet të përfshihen në raportin e Këshillit Gjyqësor për të krijuar një gjyqësor efikas dhe të kemi përparim konkret në fushën e sistemit të drejtësisë.

Pa eliminimin e këtyre dukurive negative, Këshilli Gjyqësor jo vetëm që paraqet shifra të limituara, por puna e tij do të jetë e minimizuar dhe nuk do të kryhet ashtu siç i takon me ligj e me Kushtetutë, e atëherë edhe sistemi i drejtësisë do të jetë i varur nga sistemi ndërkombëtar, konkretisht nga EULEX-i. Ju Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Të shohim sa deputetë janë në sallë. Ju kisha lutur të mos dilni nga salla për shkak se e kemi votimin.

Atëherë, po vazhdojmë me votimin e raportit të punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011.

Në sallë janë 63 deputetë. Votojmë tani! Faleminderit! Me 53 vota për, 6 kundër, 1 abstenim, Kuvendi e miratoi raportin e punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011.



Tash e kemi pikën e shtatë të rendit të ditës, për të cilën u morëm vesh në fillim:

### **7. Shqyrtimi i propozim-rezolutës Partneriteti për Ndryshimin-Fuqizimin e Gruas**

Besoj se e keni lexuar të gjithë dhe propozoj të votojmë tani. Faleminderit! Me 62 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, konstatoj se Kuvendi e miratoi rezolutën.

Pika e tetë e rendit të ditës:

### **8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat**

Siç u votua më herët Komisioni për Legjislacion, në bazë të vendimit të seancës së sotme për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, zotin Gashi që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Gashi, e keni fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Me kërkesë të seancës, Komisioni e shqyrtoi Projektligjin edhe në leximin e dytë, meqë bëhet fjalë vetëm për një nen përmbajtjesor, është neni 3 i projektligjit i cili thotë se Projektligjit për gjykatat i shtohet paragrafi i ri, si në vijim: “Gjykata Supreme vendos në shkallë të tretë për ankesat e lejuara me ligj”

Dhe, nën-paragrafi për gjykatat riemërohet 1.2 edhe vazhdim.

Komisioni ka vlerësuar se nuk ka nevojë për amendamente shtesë dhe i kërkon seancës që ta aprovojë në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Në sallë janë 67 deputetë. Votojmë tani!

Faleminderit! Konstatoj se me 67 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

Gëzuar festat e fundvitit juve dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës!  
Mirupafshim në seancat e ardhshme!

*E përgatiti:*

*Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*